

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 11.1.2007

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODDRŽANE 11.01.2007. GODINE

JANAR – JANUAR 2007

RENDI I DITËS

1. Konfirmimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, mbajtur me 14,20 dhe 21 dhjetor 2006,
3. Koha për pyetjet e deputetëve,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kimikatet,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për numrin personal,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për emrin personal,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor (pikë e shtyrë nga seanca e 14 dhjetorit 2006),
9. Shqyrtimi i Projektplanit hapësinor të Kosovës 2005-2015 (pikë e shtyrë nga seanca e 14 dhjetorit 2006),
10. Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e dy kandidatëve në Bordin e Ankesave për Media, të propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës,
11. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së për Raportin e Komisionit evropian për progresin në Kosovë (pikë e shtyrë nga seanca e 14 dhjetorit 2006),
12. Njohtimi me interpretimin e dispozitës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor,
13. Kërkesa për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radha e komuniteteve joshqiptare dhe Joserbe dhe
14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për aprovimin e transferit të mjeteve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

DNEVNI RED

1. Utvrđivanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica održanih 14,20 i 21. decembra 2006. godine.
3. Vreme za poslanička pitanja,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o hemikalijama,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o ličnom broju,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o ličnom imenu,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o pretvaranju posedovatelja privatne nekretnine na vlasnike,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o bezbednosti u drumskom saobraćaju (tačka odložena sa sednice od 14. decembra 2006. godine),
9. Razmatranje Nacrta prostornog plana Kosova 2005-2015 (tačka odložena sa sednice od 14. decembra 2006. godine),
10. Razmatranje preporuke Skupštinske Komisije za javne službe, lokalnu upravu i medije za imenovanje dva kandidata u Bordu žalbi za medije, predloženog od strane Vrhovnog suda Kosova,
11. Debata po zahtevu Parlamentarne grupe PDK o Izveštaju Komisije Evrope o progresu na Kosovu,

- (tačka odložena sa sednice od 14. decembra 2006. godine),
12. Informacija o tumačenju odredbe o imenovanju Narodnog Advokata i glavnog zamenika,
 13. Zahtev za imenovanje člana Predsedništva iz redova nealbanskih i nesrpskih zajednica i
 14. Razmatranje preporuke Komisije za budžet i financije o usvajanju transfera sredstava Ministarstva za poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj.

AGENDA

1. Approval of the agenda,
2. Approval of the minutes from the plenary sessions held on 14, 20 and 21 december 2006,
3. Time for MP questions,
4. First review of the Draft Law on Chemicals,
5. First review of the Draft Law on personal number,
6. First review of the Draft Law on personal name,
7. Second review of the Draft Law on Transformation of Private Real Estate Possesors into Owners,
8. Second review of the Draft law on Road Traffic Safety (topic that was postponed on the plenary session of date 14 December 2006),
9. Review of the Spatial Project plan of Kosovo 2005-2015 (topic that was postponed on the plenary session of date 14 December 2006),
10. Review of the recommendation for nominating of two candidates in the Board for Media Appeal, proposed from the Supreme Court in Kosovo,
11. Debate base to the request of the PDK Parliamentary Group regarding the report of the European Council for progress made in Kosovo (topic that was postponed on the plenary session of date 14 December 2006),
12. Announcement with the interpretation of the disposition for the nomination of the Ombudsperson and his main deputy,
- 13.. Request to nominate a member of the Presidency from the nonalbanian and nonserbian Community,
14. Review of the recommendation from Budget and Finance Committee to approve the budget transfer of Ministry of Agriculture, Forest and Rural Development.

Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit, z. **Kolë Berisha**, ndërsa i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Të nderuar kolegë deputetë , i nderuari kryeministër dhe kabineti qeveritar, mirë se keni ardhur në seancën e parë plenare të këtij viti të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë 84 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë të mëtejme.
Fjalën e ka kërkuar deputeti Numan Baliq.

POSLANIK NUMAN BALIĆ – Dozvolite mi da u ime grupe za integraciju kratko obavjestim sve kolege poslanike u Sali, naravno i kolege u Vladi premijera i njegove ministre da smo prekjuče kao parlamentarna grupa za integraciju zajedno sa g. Dedom, Aganiom i g. Merđom posetili familiju rahmetliu Rustema Ibišia u njegovom rodnom selu Lika u Dragašu – Gori. Mi smo nažalost posle kašnjenja i mi smo saznali za smrt g. Ibišia i dozvolite mi da u ovom prilikom kratko kažem nekoliko pojedinosti oko ovog slučaja. Nažalost bilo i subjektivnih problema same familije oko obaveštavanja njegovih kolega i prijatela tako da i ja nisam bio u prilici da prisustfujem đenazi, neki su i bili i dozvollite da ovom prilikom prenesem njihovu zahvalnost za telegram koji su dobili od Skupštine Kosova, zahvalnost predsedniku Kosova, i Predsedništvo Skupštine Kosova, takođe dozvolite mi da primjetim da nažalost bilo je ova prilika da pored subjektivnih problema o obavještanju od strane familije bilo je jedan veliki nedostatak u tom smislu što ni jedan javni televizijski, ni jedna nacionalna telelvizija Kosovska nije objavila vjest o smrti poslanika što ne bi trebalo da se desi, jer se radi o našem kolegu, poslaniku Skupštine Kosova i dozvolite da na kraju kažem da bi bilo dobro da se u narednih nekoliko dana dogovorimo oko toga da jedna delegacija Skupštine predvođena predsednikom ili neko od predsedništva poseti familiju rahmetliju Rustema Ibišija. Hvala vam ljepo!

KRYETARI I KUVENDIDT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, prandaj ftoj deputetët për një minutë heshtje.

L a v d i.

Po ashtu e shoh të arsyeshme që në fillim të seancës t’i them edhe unë dy fjalë.

Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryeministër Çeku dhe kabineti qeveritar, të nderuar pjesëtarë të korit diplomatik të akredituar në Kosovë, zonja dhe zotërinj.

Meqë kjo është seanca e parë plenare me të cilën po fillojnë punimet e këtij kuvendi në vitin që sapo kemi hyrë, më lejoni që duke ju falënderuar të gjithëve në radhë të parë për kontributin e dhënë gjatë vitit që shkoi, qoftë në grupe parlamentare, qoftë në seancat plenare, komisione dhe në trupat e tjera punuese të Kuvendit dhe po ashtu duke ju falënderuar për mirëkuptim dhe bashkëpunim korrekt gjatë këtij viti që shkoi, sot në emër të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe në emrin tim personal uroj që në vitin e ri 2007 të keni në radhë të parë shëndet, suksese të mëdha dhe punë të mbarë.

Të nderuar të pranishëm, unë dola sot këtu që në fillim me pak fjalë të bashkë përkujtojmë se viti në të cilin po hyjmë vërtet është vit vendimtar, vërtet vit historik për Kuvendin dhe popullin e Kosovës, kur kihet parasysh pesha e çështjes me të cilën shumë shpejt duhet të përballemi. Roli historik që e kemi, përgjegjësia po ashtu historike që e kemi ndaj së sotmes dhe së nesërme së këtij populli e mbi të gjitha kur kihet parasysh fakti se në histori mund të hyjmë si triumfues nëse arrijmë t’i realizojmë qëllimet tona, por në histori mund të hyjmë edhe si diçka tjetër, nëse gjatë këtij viti kritik nuk do të dimë që ta luajmë edhe potezin e duhur, atëherë lind nevoja për një mobilizim më të madh të të gjithë neve së bashku, në mënyrë që t’i përmbushim premtimet që ia kemi dhënë elektoratit tonë. Duhet ta përmbushim porosinë e atyre që u flijuan për një qëllim të vetëm, realizimin e asaj që është qëllim i të gjithë neve sot këtu.

Kolegë të nderuar nuk kam për qëllim që te ju të ngjall shqetësim lidhur me proceset që i kemi përpara, por ajo që kërkohet prej nesh është punë me përgjegjësi, ndërgjegjshmëri dhe koshiencë jona për proceset, nëse të tjerët flenë edhe ditën, ne nuk do të duhej të flenim as natën. Çështja sa është motivuese dhe emocionuese aq është edhe serioze. Së këndejmi dua t’ju them se gjatë muajve në vijim ky Kuvend do të përballlet me sfida ndër

më të ndryshmet dhe ndër më të rëndat. Ky kuvend do të marrë ,ndoshta, vendime shumë të vështira, vendime që do ta përcaktojnë dhe do ta definojnë qartë fatin e Kosovës, fatin e fëmijëve tanë dhe të fëmijëve të fëmijëve tanë. Dua të tërheq vërejtjen se ky Kuvend shumë shpejt dhe ndoshta që në seancën e ardhshme pas konsultimit dhe harmonizimeve të qëndrimeve ndërmjet subjekteve politike me procedurë të rregullt kushtetuese do t'i përcaktojë kriteret dhe do të marrë vendim për miratimin e Këshillit Kushtetues i cili do ta hartojë kushtetutën e re, kushtetutën e parë në Kosovën e pavarur. Dua të vë në spikamë se ky Kuvend, po ashtu shumë shpejt do të përballet me çështjen e simboleve siç janë: flamuri, himni dhe simbolet e tjera të shtetit të ardhshëm të Kosovës. Shumë shpejt do ta kemi para vetes për shqyrtim të ashtuquajturën paketë e Ahtisarit dhe jemi në këtë Kuvend, ata që asaj pakete duhet t'i japim përgjigjen e duhur. Ky Kuvend shumë shpejt do t'i ketë para vetes për shqyrtim dhe miratim një numër të madh projektligjesh dhe aktesh të tjera nënligjore, me të cilat do të rregullohen fusha të ndryshme të jetës tani në rrethana të reja në një Kosovë të pavarur dhe sovrane. Pra, komisionet duhet të jenë shumë më azhure, por të gjitha këto detyra ,saqë të na duken të rënda, ne do t'i përmbushim me lehtësi nëse vërtet jemi unikë, nëse vërtet jemi të përgjegjshëm, nëse vërtet e duam këtë vend, e duam këtë tokë ,siç po deklarohe mi çdo ditë. Por po ashtu në rast nevojë ky Kuvend pas konsultimeve paraprake do të dijë që me kohë dhe mjete të duhura të veprojnë në harmoni me rolin, kompetencat dhe mandatin që e ka marrë nga populli.

Andaj, kolegë të nderuar deputetë, kryeministër Çeku, zëvendëskryeministër, ministra dhe zëvendësministra të Qeverisë së Kosovës, njerëz të këtij vendi të shenjtë dhe të shtrenjtë ju thërras jo vetëm si kryetar i Parlamentit të Kosovës, jo vetëm si koleg, si mik dhe si bashkëqytetar juaji, por ju lus që derisa të përfundojë procesi i definimit të statusit të Kosovës, derisa të bëjmë kushtetutën tonë, derisa duhet t'i mbajmë zgjedhjet e para lokale dhe nacionale dhe ta formojmë Qeverinë e parë të Kosovës së pavarur, t'i lëmë me një anë kundërthëniet e çastit, t'i lëmë me një anë interesat e ngushta partiake, të kaluara, ideologjike, fafëfisnore etj. të cilat në raste normale do të ishin shumë të pranueshme.

Më lejoni që ta përsëris konstatimin që e dua shumë: “Janë 99 fije që na bashkojnë dhe vetëm një madje edhe shumë e hollë që mund të na ndajë”. Një fjalë e urtë thotë: “Nëse nuk jemi së bashku në të njëjtin front do të jemi së bashku në të njëjtin litar”, prandaj ju ftoj që të gjithë së bashku, pozitë dhe opozitë, shumicë dhe pakicë të jemi në nivel të përgjegjësisve që kemi, të jemi unikë në vendimmarrje, të jemi të përgjegjshëm për rolin historik që kemi.

Në emër të të gjitha këtyre që u thanë dhe të shumë të tjerave që nuk u thanë, në emër të së sotmes dhe të së nesërme uroj që të kemi një vit të suksesshëm dhe punë të mbarë.

Ju faleminderit!

Fillojmë me punë të seancës së Kuvendit.

Në pajtim me rregullat 6 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit e propozon rendin e ditës të seancës së sotme plenare sipas shkresës që u është shpërndarë të gjithëve. Meqë Kryesia nuk ka marrë asnjë propozim tjetër me shkrim për plotësimin e rendit të ditës, atëherë në pajtim me rregullën 23.2 konstatoj se rendi i ditës është miratuar.

Rreth rendit të ditës mund të bisedohet dy minuta.

Fjalën e ka Besa Gaxherri.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI- Faleminderit z. kryetar, kolegë të nderuar, z. kryeministër me kabinetin e tuaj.

Edhe unë shfrytëzoj rastin, pasi që është seanca e parë pas vitit 2006, t'ju uroj të gjithëve sukses dhe për të qenë të suksesshëm për ato të cilat i ceku edhe kryetari i Kuvendit ,duhet të jemi të gjithë në nivel të detyrës me përgjegjësitë që i kemi marrë.

Lidhur me këtë dhe me rendin e ditës unë dua të kërkoj urgjentisht të na njoftoni ju dhe sponsori i ligjit për memorialin e presidentit Rugova, pse nuk është në rend të ditës. Për Kosovën fatkeqësisht u desht shumë sakrificë deri në vetëflijim, andaj ne kemi obligim që t'u japim respekt dhe mbështetjen institucionale të gjithë krerëve dhe familjeve të tyre e në veçanti presidentit Rugova të cilin e nderon jo vetëm bota shqiptare, por tashmë ai është edhe personalitet ndërkombëtar.

A nuk ju vjen turp që tani të bëhet një vit dhe asnjë hap në shenjë nderimi nuk kanë bërë këto institucione për të. Ju nuk jeni në gjendje një ligj ta miratoni në Kuvend, cilido delegacion kombëtar dhe ndërkombëtar kur vjen në Kosovë shkon të përulet para varrit të tij dhe ju nuk skuqeni dhe as nuk turpëroheni se nuk keni bërë qe një vit asnjë investim në atë vend. Të vetmen gjë që e keni bërë ju për të është të dëmtohet krejt çka ka krijuar ai e që kjo kurrë nuk do t'ju lejohet nga qytetarët e Kosovës. Mos tentoni të jepni përgjigje se gjoja qenkan implikime buxhetore të paanalizuara mirë. Sikur të kishte qenë vullneti i institucioneve për angazhim rreth memorialit dhe familjes, edhe familjet që jetojnë me ndihmën sociale në Kosovë do të ishin përgjigjur financiarisht për presidentin Rugova. Është e papranueshme për LDK-në të lejojë të bëhet lojë me këtë ligj.

Krejt në fund, se dua të jem e shkurtër, jua përkujtoj vetëm këtë gjë. Përveç kontributit të pazëvendësueshëm dhe të paparë që ka dhënë vetë presidenti Rugova ,ju them se fëmijët e tij janë rritur pa fëmijëri, ata 16 vitet e rinisë së tyre i kaluan brenda mureve të rezidencës, ata meritojnë respektin e institucioneve të Kosovës ose së paku respektin e Lidhjes Demokratike. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e kërkon z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar ministra dhe deputetë. Unë do të jem në rendin e ditës. Pasi Grupi Parlamentar i PDK-së ka kërkuar që në këtë Kuvend të debatohet për raportin e Komisionit Evropian, konsiderojmë se ka kaluar shumë kohë, tanimë kjo çështje nuk është aq me interes të debatohet edhe në një formë një lloj proteste që kërkesat e Grupit Parlamentar që kërkojnë të debatohen me urgjencë është mirë që të debatohen me kohë dhe mbas kohe.Konsiderojmë se në Kosovë dhe për Kosovën edhe për vetë Parlamentin ka çështje shumë më të ngutshme dhe shumë më substanciale, prandaj kërkoj që pika 11 të hiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Kërkohet të votohet për heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës.

Propozimin e Jakup Krasniqit e vë në votim.

Për
Kundër5

Ju faleminderit.

Konstatohet se pika 11 e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës për këtë seancë.

Fjalën e ka deputeti Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar këtë rend të ditës dhe nga deputetja Nekibe Kelmendi e cila e udhëheq një prej komisioneve shumë të rëndësishme kemi lutje që lidhur me pikën 7 të rendit të ditës të jepen sqarime që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga seanca e sotshme. Po ashtu edhe pika 14, kërkojmë nga kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa z. Naser Osmani, njëherit ish- anëtar i Grupit Parlamentar të LDK-së , të japë sqarime për heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës për seancën e sotme. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Znj. Nekibe doni t'i jepni sqarimet, urdhëroni ju lutem.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar qeveritarë, të nderuar deputetë.

Në procedurë parlamentare, në lexim të parë, është miratuar Ligji për shndërrimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë. Nr. 2006/XX. Lidhur me këtë ligj Komisioni funksional, pra Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka mbajtur disa seanca dhe e ka shqyrtuar këtë ligj. E ka parë të arsyeshme që të mbajë edhe një debat publik lidhur me këtë ligj dhe në atë debat ka ftuar ekspertët e fushës përkatëse, përkatësisht ekspertë të dalluar të materies civile, gjyqtarë të të gjitha niveleve, si dhe funksionarë të komunave. Në atë debat është dhënë një shpjegim jashtëzakonisht profesional dhe i arsyeshëm ,që pastaj ne e kemi shqyrtuar përsëri në mbledhjen e Komisionit Parlamentar dhe pas kësaj kemi ardhur në përfundim se ky projektligj duhet të tërhiqet në tërësi nga sponsori, sepse shumë nene të këtij ligji janë të rregulluara me ligjet e tjera. Ndërkaq ky ligj ka mbetur vetëm në një nen i cili do të duhej të rregullohej në këtë ligj, por ligj me një nen nuk ekziston. P.sh në tekstin e Projektligjit në fjalë neni “1ii” prona e paluajtshme është dhënë përkufizim i njëjtë i cili është dhënë edhe në Ligjin për kadastrë. Neni “1ii” i tekstit të Projektligjit, nocioni “posedim”, një term i mangët, sepse anashkalohet termi “vendimi gjyqësor” që përfaqëson një bazë të vlefshme juridike me të cilën rregullohen raportet juridike. Me këtë ligj, për të cilin po propozoj të tërhiqet nga ana e sponsoruesit është marrë si dokument valid dhe i vetëm për argumentimin e së drejtës pronësore fleta poseduese që nuk do të ishte kështu ,sepse çështja e pronësisë rregullohet me ligj të posaçëm, me Ligjin mbi pronën, kurse fleta poseduese është një dokument mbi regjistrin në kadastrë, ekzistimin e një të drejte në regjistrin ose të kadastrit ose të librit për regjistrimin e paluajtshmërive.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Për të mos hyrë në detajet e ligjit edhe ashtu e kemi pasur rekomandimin që seanca plenare e Kuvendit të Kosovës projektligjin në fjalë t'ia kthejë sponsoruesit prapë. Duhet edhe një votë formale edhe për këtë:

Kush është për? Ju faleminderit.

Kundër 1

Ju faleminderit, shumica absolute është për atë që të hiqet nga rendi i ditës.

Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Faleminderit i nderuari kryetar. Pika 14 e rendit të ditës që ka të bëjë me transferin e mjeteve financiare për Ministrinë e Bujqësisë, konsideroj se duhet të hiqet pasi që kjo është dashur të aprovohet në vitin fiskal 2006, me qenë se është

aprovuar buxheti për vitin 2007 dhe ne kemi hyrë në këtë periudhë buxhetore, konsideroj se kjo është më e pavlerë dhe kërkoj që të tërhiqet nga rendi i ditës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ju lutem një votë formale edhe për këtë.

Përshumica,
Kundër..... s'ka.

Ju faleminderit. Konstatoj se edhe pika e 14 të hiqet nga rendi i ditës.
Fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, ministra, kolegë deputetë.

Gjithnjë rreth rendit të ditës edhe të shqetësimeve të Grupit Parlamentar për Integrim, kohë më parë kemi kërkuar që edhe Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka aprovuar një kërkesë tonën për ta futur në rend dite çështjen e një informate, respektivisht raporti që do të duhej të na jepte Ekipi i famshëm Negociator, d.m.th përkitazi me shtyrjen e statusit të Kosovës. Ju z. kryetar na premtuat se në njërin prej seancave të ardhshme do t'i ftoni përfaqësuesit dhe ne nuk po shohim që as e qitni në rendin e ditës dhe as që i ftoni dhe kemi dëshirë që të na jepni një përgjigje. Ju z. kryetar, posa folët për unitetin dhe kam dëshirë ta kemi unitetin, por jo unitetin e mentalitetit ballkanik, diçka tjetër të flasim e diçka tjetër të punojmë dhe diçka tjetër të veprojmë dhe të themi, por të kemi një unitet vërtet të sinqertë që nuk po e shohim. Ne nga mediat si grup parlamentar për integrim po njoftohemi se partitë tashmë po ndahen në parti negociatore dhe jonegociatore, parti të përfaqësuara në Ekipin Negociator, kurse në botën demokratike partitë ndahen në parti parlamentare dhe parti joparlamentare, kështu që nga mediat lexuam se keni formuar një grup punues për kushtetutën e Kosovës.

Ndërhyrje nga kryetari,

Gjergj po flasim për rendin e ditës.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Është me rëndësi që këtë ta futni në rend dite, po në fund kam me kërku që sot të votohet dhe të hyjë në rend dite, d.m.th janë çështje kruciale për të cilat ju po doni me i mbyllë sytë dhe ne s'e kemi ndërmend si deputetë ose shpërndane këtë Kuvend, le ta udhëheqë Kosovën Grupi Negociator dhe s'kemi nevojë të malltetrohemi para asnjërit. D.m.th është e papranueshme që të anashkalohen 17 parti politike dhe 7 grupe parlamentare dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe grupet parlamentare të njoftohen nga gazetatat për formimin e grupit dhe është e papranueshme për kushtetutën, për simbolet, për statusin, zgjedhjet që të anashkalohen grupet parlamentare dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kërkoj nga ju z. kryetar që t'i ushtroni mandatin dhe autoritetin tuaj që të rishqyrtohen dhe të debatohet më së pari në Kuvend para se të formohen këto grupe. Ky Kuvend është ai trup i cili reflekton vullnetin e të gjitha partive politike, të gjitha grupeve etnike, të gjitha grupeve politike dhe jo Grupi Negociator që për mendimin tonë tashmë i ka skaduar afati politik moral dhe kredibiliteti që e ka. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Një përgjigje e shkurtër për pyetjen e parë. Ligji është tërhequr nga rendi i ditës për ta kompletuar më mirë dhe për ta pasur deklaratën mbi shpenzimet ose implikimet buxhetore.

Është tërheqje e përkohshme dhe shumë shpejt do të jetë në rendin e ditës dhe do të shqyrtohet në këtë Kuvend.

Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit

A ka dikush vërejtje rreth procesverbalit, apo të kësaj pike të rendit të ditës?

Nëse deputetët nuk kanë vërejtje konkrete konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të dt. 14 dhe 20 dhe 21 dhjetor të vitit 2006.

3. Koha për pyetje të parlamentarëve

Pyetjet kanë qenë nga deputeti Xhevat Bislimi, për ministrin Ibrahim Selmanaj, nuk është këtu ministri.

Xhevat Bislimi, pyetje për ministrin Agim Veliu, i cili nuk është këtu dhe kërkojmë falje se për shkak të obligimeve që i ka pasur nuk ka pasur mundësi të vijë. Në seancën e ardhshme do të jetë dhe do të japë përgjigje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kimikatet

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 13 dhjetor të vitit 2006 dhe janë plotësuar kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj sponsoruesin që ta marrë fjalën.

ARDIAN GJINI MINISTËR –I nderuar kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor e ka parë të arsyeshme që ta hartojë Ligjin për kimikatet, për shkak se aktet ligjore dhe ligjet ekzistuese të deritanishme nuk e kanë përmbyll gjithë nevojën për rregullimin me ligj të përdorimit, të shfrytëzimit dhe të prodhimit të materieve kimike në Kosovë.

Industria kimike, si në të gjitha vendet e tjera edhe në Kosovë, është ose do të shndërrohet shpejt në degë të rëndësishme të industrisë dhe për një gjë të tillë neve na duhet që të kemi rregulla ta sakta.

Materjet kimike të cilat përdoren, qoftë si preparate, por edhe si lëndë e parë për prodhimet e tjera të mjeteve të tjera të punës ose lëndëve të tjera, mund të jenë po ashtu edhe të dëmshme për njeriun dhe për mjedisin, në të cilin ne jetojmë.

Ligji i hartuar nga Ministria e Mjedisit përmban 8 kapituj dhe 36 nene të ndara si më poshtë.

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme, që kanë për qëllim të rregullojnë administrimin e qëndrueshëm, tregtimin dhe përdorimin e kimikateve, duke i përfshirë masat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, nga kimikatet e rrezikshme.

KAPITULLI II

Regjistrimi, lëshuarja në treg dhe përdorimi i substancave të reja, që përcakton rregullat për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e substancave të reja, në veçanti procedurat për notifikim dhe kërkesat për dokumentim, si dhe testimet shtesë për substancën tashmë e cila do të jetë e notifikuar.

KAPITULLI III

Vlerësimi i substancave të reja, trajton çështjen e vlerësimit teknik për vetitë e substancave të reja, përshkruan detyrimet e personave juridikë, respektivisht të Ministrisë për zbatim të këtij ligji. Po ashtu krijon bazën për bashkëpunim ndërkombëtar në këtë fushë dhe mundëson ndërlidhjen me organizatat e BE-së për tregtim të kimikateve, duke iu referuar regjistrave evropian për lloje të ndryshme të substancave.

KAPITULLI IV

Klasifikimi, paketimi dhe etiketimi i kimikateve të rrezikshme, që ofron bazën juridike për të krijuar rregullat për klasifikim, paketim dhe etiketim të kimikateve.

KAPITULLI V

Tregtimi dhe përdorimi i kimikateve të rrezikshme, që krijojnë mundësi për hartimin e rregullave për tregtimin dhe përdorimin e kimikateve dhe ofron bazë për zbatim të rregullave të detajuara mbi kushtet për prodhim, qarkullim dhe shfrytëzim

KAPITULLI VI

Mbikëqyrja dhe kontrolli, me të cilin përcaktohen rregullat për mbikëqyrje dhe kontrollim të kimikateve. Emëron autoritete të përgjegjshme për këto detyra dhe cakton të drejtat dhe detyrimet e tyre, sikurse të organit përgjegjës për kimikate, organit të kontrollit zyrtar, të drejtat e inspektorit dhe të drejtën e ankesës.

KAPITULLI VII

Masat ndëshkuese, që paraqet shkeljet e dënueshme sipas këtij ligji dhe cakton gjobat.

KAPITULLI VIII

Së fundi, ligji përmban dispozita kalimtare dhe të fundii Nevojën e nxjerrje së ligjit e përmenda në fillim, besoj se nuk ka nevojë të përsëritet se rregullimi i prodhimit dhe përdorimit të kimikateve është i një rëndësie tejet të madhe për shëndetin e qytetarëve dhe për mjedisin. Hartimi i ligjit është mundësuar përmes punëtorëve të Ministrisë së Mjedisit. d.m.th punëtorëve të Ministrisë së Mjedisit dhe me ndihmën e Agjencisë Evropiane për Rindërtim e cila po ashtu ka mundësuar që ky ligj të mbajë në vete **gjithë trupin** e rregulloreve të përbashkëta dhe ligjeve të Unionit Evropian.

Ministria vlerëson se Ligji krijon kushte themelore për administrim të kimikateve në Kosovë se mbështet nevojën se çështja dhe fusha e kimikateve, e mbrojtjes së shëndetit publik dhe e mbrojtjes së mjedisit do të plotësohen dhe kompletohen në tërësi me nxjerrjen e akteve adekuate nënligjore të cilat do të pasojnë pas këtij ligji.

Pas gjithë kësaj unë i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës ta aprovojnë ligjin për kimikatet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër , deputeti Lulzim Zeneli në emër të LDK-së.

DEPUTETI LULZIM ZENELI – I nderuari z. kryetar, i nderuari ministër.

Ligji për kemikatet që synon të rregullojë qarkullimin e substancave kimike në vend edhe për nga natyra e vet kësaj materieje konsideroj se duhet të jetë shumë më konciz dhe më i qartë në përmbajtje. Për vetë faktin se është një ligj që nuk është voluminoz dhe konstruktiv të kësaj materieje i nevojitet një qasje më e drejtpërdrejtë, pa hyë në detaje për vërejtjet tona si grup parlamentar. Ne si Grup Parlamentar i LDK-së e përkrahim në parim miratimin e këtij projektligji, ndërsa vërejtjet të cilat i kemi do t'i procedojmë sipas procedurës së amendamentimit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputeti Berat Luzha në emër të PDK—së.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Z kryetar, z. ministër, kemi dy vlerësime zyrtare kontradiktore në këtë projektligj. Në memorandumun shpjegues i cili është mjaft i mangët për mendimin tim sponsoruesi deklaroi se ky projekt është në përputhje me rregulloret evropiane të kësaj fushe, kurse Agjencioni për Integritet Evropian në deklaratën e vet ka vlerësuar se Projektligji për kemikatet nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane. Vlerësojmë se titulli apo emri i ligjit nuk korrespondon plotësisht me përmbajtjen e ligjit, prandaj propozojmë që të ndërrohet emri dhe të quhet: “Projektligji për notifikimin e substancave të rrezikshme kimike”. Projektligji është i hartuar dobët me një gjuhë të rëndë të paqartë dhe të papërshtatshme normative. Ai do të mund të ishte shumë i shkurtër dhe më i thjeshtë. Me gjithë vërejtjet Grupi Parlamentar i PDK-së pajtohet që ky ligj të vazhdojë procedurën për miratimin e mëtejshëm në Kuvend. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-së fjalën e ka deputeti Mazllo Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA - Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së e ka pasur në dorë këtë projektligj dhe me këtë rast ka konstatuar. Së pari përgëzojmë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për përpjekje për të bërë një ligj që konsiston të rregullojë qarkullimin e substancave të rrezikshme në Kosovë, duke pasur për objekt mbrojtjen shëndetësore dhe mjedisore.

Së dyti, në këtë projektligj po formësohet një infrastrukturë ligjore në mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit në Kosovë, e cila deri më tani na ka munguar dhe gjithnjë ka paraqitur rrezik permanent.

Së treti, Kosova pretendon të zhvillojë një tregti të lirë dhe një qarkullim tregtar po ashtu të lirë. Në këtë kontekst nuk duhet shmangur sidomos një qarkullim dhe tregtim të substancave dhe të preparateve të rrezikshme çfarë na detyrojnë dokumentet dhe konventat e Bashkësisë Evropiane.

Vlerësojmë pozitivisht se ky projektligj ka arritur të mbështetet në legjislacionin, standardet dhe direktivat e Bashkësisë Evropiane.

Gjatë vlerësimit Grupi i AAK-së propozon të bëhen disa përmirësime, duke i shmangur disa paqartësi, sidomos në shpjegimin e përkufizimeve/ Po ashtu mendojmë se këtij projektligji i duhet edhe një trajtim i veçantë për disa përdorime të gabuara të shqipes e sidomos në kreun e gjashtë.

Si përfundim Grupi i AAK-së në tërësi e vlerëson të kalueshëm këtë projektligj dhe kërkon t'i hapim rrugë duke i siguruar edhe kontributin tonë në procedim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të ORA-s deputeti Gazmend Muhaxhiri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHIRI – Projektligji në fjalë e ka deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, deklarata është shumë e qartë. Konsiderojmë se Projektligji për kemikatet nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin. Para se të vijë ky projektligj në Kuvend pasi që e ka pasur këtë vërejtje të Agjencisë për Integritet Evropian ka qenë e udhës që këtë projektligj ta harmonizojë me legjislacionin e BE-së. Na vjen në Kuvend dhe ta votojmë një ligj i cili është në harmoni me legjislacionin e BE-së. Në të kundërtën, me këtë që ka ndodhur do të detyrohemi që brenda 1 viti ose në mandatin e ardhshëm të Kuvendit ta miratojmë një ligj tjetër dhe ta harmonizojmë me legjislacionin e BE-së, kështu që duhet të bëjmë një punë të dyfishtë. Pse Ministria e cila ka qenë sponsorizuese e këtij projektligji nuk i ka marrë parasysh vërejtjet e Agjencionit për Integritet Evropian dhe me prurjen e ligjit harmonizuar. Duke e pasur parasysh këtë fakt Grupi Parlamentar i ORA-s nuk i jep mbështetje këtij projektligji.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ Rifat Krasniq.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ – Ju faleminderit z. kryetar.

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Kimyasal maddelere ait Yasa Tasarısı

Bu Yasanın amacını, yaşam ortamının korunum önlemleri ile insanların kimyasal maddelerle karşı karşıya gelmesi, maddeler oluşumunun doğrulanması, enformasyonların sunulması, maddelerin sınıflandırılması, kimyasal maddelerin etiketlenmesi ile paketlenmesi, tehlike derecesinin değerlendirilmesi, tehlikeli kimyasal maddelerin üretimi, alışverişi ve istifade edilmesiyle ilgili koşulların sağlanması ve bununla birlikte maddelerin denetlenmesi ile müfettişler tarafından incelenmesini ilave ederek, kimyasal maddelerin sürekli olarak yönetilmesinin düzene koyulması teşkil etmektedir.

Söz konusu Yasa, nihayi durumda olan maddeler, insanlar ya da hayvanlar için sağlıkta kullanılacak olan tıbbi ürünleri, artıklar şeklinde bileşimlerin karışımı, beslenme üretimleri ve radyoaktif bileşimleri için uygulanmayacaktır.

Aynı zamanda bu Yasa, bütünlüklü değerlendirmeyi öngörmektedir. Yeni bileşimin değerlendirilmesini yapan her kişi, konuyla ilgili Bakanlık haberdar etmeli ve zamanında değerlendirilmiş olan ve piyasaya sunulan bileşimlerle ilgili ek testi yapmalıdır.

Bu Yasa, yeni bileşimlerin Bakanlık tarafından sürekli olarak değerlendirilmesini öngörmektedir, uluslararası seviyede ise Bakanlık, yeni bileşimlerle ilgili verilerin değiş tokuşu yönünde çalışmalarını sürdürecektir. Kimyasal maddeleri üretmek, satmak ya da kullanmak isteyen her kişi, yaşam ortamına etki etmesi derecesinin değerlendirilmesi yöntemini uygulamaya zorunludur.

Sözkonusu Yasa, ceza önlemlerin uygulanmasını da öngörmektedir. Bu önlemler sayesinde, değişik türdeki artıklarla yüklü olan yaşam ortamımızın kirlilik derecesi azalmış olacaktır.

Fakat, varolan zayıflıkların ortadan kaldırılması amacıyla, Fonksiyonal Komisyon, Meclisin diğer komisyonlarına çağrıda bulunarak, bu Yasa Tasarısını görüşecektir.

İlginize teşekkürler!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Qëndron fakti z. kryetar i Parlamentit se në deklaratën e BE-së thuhet se ky ligj nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së, por nuk thuhet se ligji është i tëri në kundërshtim me ligjet e BE-së. Nga ana tjetër nga një diskutues u nxor vetëm një fjali nga konteksti i deklaratës, duhet të lexohet edhe fjalia e dytë që thotë: “Rekomandojmë që të merren për bazë të gjitha rekomandimet e bëra në kuadër të opinionit ligjor”. Prandaj mendoj se ky ligj duhet në parim të miratohet, kurse në fazat e ardhshme të amendamentimit t’u përshtatet edhe rekomandimeve edhe standardeve të BE-së.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka ministri Gjini.

ARDIAN GJINI , MINISTËR – Ju faleminderit z. kryetar. E falënderoj znj. Kelmendi që unë vetëm desha t’i them nga rekomandimet që i ka nxjerrë Departamenti për çështje të harmonizimit të legjislacionit me atë të Unionit Evropian. Ajo që dua t’ju them sot është se në fjalën time unë thashë se është në harmoni me trupin e ligjeve të cilat ne i marrim si të përbashkëta në UE-në. Dua t’ju them se ka shumë vende në UE-në që nuk do t’i zbatojnë deri në vitin 2010 të gjitha dispozitat e përbashkëta e jo vetëm Kosova. Dua t’ju them se në këtë fazë të zhvillimit ekonomik dhe industrial të Kosovës është praktikisht e pamundshme që të gjitha rregulloret e përbashkëta të UE-së të aplikohen në ligjet të cilat rregullojnë veprimtari ekonomike. Është e vërtetë që ne duhet ta amendantojmë ligjin në të ardhmen, që duhet të nxjerrim amendamente në vazhdimësi në përputhje me zhvillimin ekonomik që do ta ketë Kosova dhe me zhvillimet e tjera që do të vijnë si industriale, po ashtu edhe teknologjike. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e kërkon z. Muhaxhiri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHIRI - Z. kryetar. Projektligji nuk është në përputhje të plotë, ne nuk kemi mekanizëm në Kuvendin e Kosovës për ta vërtetuar se në çfarë sasive ky përputhet ose nuk përputhet. Edhe komisioni i cili do ta trajtojë këtë nuk ka mekanizëm për ta vlerësuar këtë punë që të mund të bëjë përputhjen me legjislacionin e BE-së. U bë përputhje me legjislacionin e BE-së agjensioni për integritet Evropian që është pranë Qeverisë ka mundësi me të këtë i ka rekomanduar ministrisë me të, ministria nuk e ka bërë, është dashur deputetëve të Parlamentit të Kosovës me ju ardhë edhe bashkangjitur edhe shkresa me rekomandime dhe opinionet e këtij agjensioni asnjë herë nuk po i vjen, kishte me qenë ma në rregull që deputetëve me ju shpërndarë edhe kjo shkresë edhe me ju pa pse nuk është në përputhje edhe sa nuk është në përputhje, pasi nuk është kjo shkresë ne si grup parlamentar e kundërshtuam se s’kemi mekanizëm si Kuvend me e përshtatë ose me rregulluar me legjislacionin e BE-së . Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit Meqenëse nuk ka kandidatë tjetër për diskutim lus deputetët dhe regjinë të përgatitet për votim të ligjit në parim.

Votojmë tash:

Në sallë momentalisht kemi 81 deputetë.

Për 60,

Kundër 17.

Aprovohet në parim Projektligji për kimikatet.

Në bazë të rregullës 23.pika 6 të rregullës 35.2. Kuvendi i ngarkon këto komisione:

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural , Mjedis dhe Planifikim Hapësinor si komision funksional dhe referues.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,

Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe

Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i Projektligjit të shqyrtojmë dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës.

5. SHQYRTIMI I PARË I PROJEKTLIGJIT PËR NUMRIN PERSONAL

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 20 dhjetor 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Rexhepi për ta prezantuar këtë projektligj.

MINISTRI FATMIR REXHEPI – Ju faleminderit z. kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë ,të nderuar kolegë të kabinetit qeveritar.

Në kuadër të pakos së projektligjeve të përgatitura nga Ministria e Punëve të Brendshme është edhe Projektligji për numrin personal që është ofruar sot për procedim.

Fushëveprim i Projektligjit është përcaktimi i numrit personal, i kuptimit të përbërjes, procedurat dhe mënyra e caktimit të numrit personal. Nevoja për këtë projektligj është rregullimi ligjor i caktimit të përbërjes dhe i mënyrës së caktimit të numrit personal për shtetasit e Kosovës dhe të huajtë i bazuar dhe i harmonizuar me standardet dhe praktikat më të mira. Projektligji ka 7 kapituj dhe gjithsej 17 nene nga dispozitat e përgjithshme deri te dispozitat e fundit. Projektligji përcakton rregullat dhe mënyrat për caktimin e numrit personal për shtetasit e Kosovës , si dhe për të huajtë të cilëve u është lejuar qëndrimi i përhershëm ose u është pranuar statusi i azilantit në Kosovë ,si dhe përcakton se numri personal është 13 shifror i ndarë në 6 grupe që flasin për rëndësinë e kësaj ndarjeje. Po ashtu përcakton rregullat e përmirësimit të numrit personal të caktuar

gabimisht, organi i cili është kompetent për të ndryshuar numrin personal të caktuar gabimisht, si dhe përgjegjësitë e Ministrisë për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligjit.

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde që përdoret për legjislacionin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisë të Kosovës dhe është në pajtim me Kornizën Kushtetuese, me Rregulloren mbi bartjen edhe transferin e përgjithësive për Ministrinë nr. 26.2006.

Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete buxhetore shtesë të cilat janë parashikuar dhe planifikuar në kuadër të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 dhe shifra e saj është paralogaritur dikur rreth 580 mijë euro dhe në fazën e implementimit, pra pas aprovimit do të pasojë me ndryshimet dhe dokumentacionin civil dhe dokumentacionet e reja të cilat pra do të jenë ndryshe me ato që i kemi aktualisht. Duke ju falënderuar për vëmendjen tuaj dhe me shpresë se duhet përgatitur dokumentacioni sa më i shpejtë, i ndryshuar, është pra në mandatin e deputetëve dhe të komisionet profesionale të ofrojnë vlerësimet e tyre në fazën shqyrtimit të mëtejme. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, në emër të LDK-së.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari kryetar, Grupi Parlamentar i LDK-së i ka shqyrtuar me vëmendje dhe ka debatuar për këto dy ligje. Ligji për numrin personale dhe Ligji për emrin Personal. Ne në parim kemi marrë qëndrim që këto dy ligje t'i mbështesim dhe këto të miratohen në lexim të parë. Mirëpo konsideroj se ligj bazik për këto dy ligje është ligji mbi gjendjen civile i cili është sa kam informacione është përfunduar dhe në fund të janarit nga Qeveria si sponsoruese do t'i dorëzohet në procedurë parlamentare këtij parlamenti. Për këtë arsye unë mendoj se këto dy ligje sot të miratohen në parim, por të pritet më vonë me amandamentimin e tyre, në mënyrë që mos i përsëritë gjërat me Ligjin për gjendjen civile, i cili si e thashë edhe është një ligj bazik si për emrin personal si për Ligjin për numrin personal si për Ligjin për statusin në familje apo gjendjet familjare e tjera.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të PDK-së Gani Koci

DEPUTETI GANI KOCI – Ju faleminderit z. kryetar që Kosova ka nevojë për ligje të tilla si është Ligji mbi emrin personal dhe mbi numrin personal. nuk do komentë, Do të pajtohesh me pjesën e parafolësës zonjës Nekibe që vërtet janë çështje që përcaktojnë statusin civil të qytetarit edhe emri personal edhe numri personal edhe vendbanimi, edhe vendqëndrimi si të tilla do të duhej të trajtoheshin vërtet në një ligj të vetëm bazik dhe pastaj me aktet e tjera nënligjore kjo do të ishte përgjegjësi e Ministrisë të përcaktojë edhe format dhe procedurat, pastaj të kësaj rregullative. Dihet se personat fizikë kanë disatribute që shërbejnë për identifikimin e tyre dhe caktimin ose përcaktimin e statusit juridik të tyre dhe një nga këtotribute është edhe emri që në teori e drejta për emër njihet si e drejtë absolute personale ose subjektive, ndërsa numri personal ka të bëjë më tepër me krijimin e bazës së të dhënave të qytetarëve që më tepër është një çështje administrative, por që këto të dyja shkojnë krahas dhe sipas kësaj së drejte secili që lind ka të drejtë pr emër dhe ka të drejtë të shënohet në një libër civil që quhet libri amë i të lindurëve dhe me shënimin e emrit personal. Po ashtu sipas praktikave të deritashme në këto libra shënohet edhe numri personal i qytetarit, prandaj si të tilla nuk do të duhet të

na ofroheshin si dy projektligje, por do të duhej të jetë si një ligj i vetëm që do të mbante ose do të quhej ligji për emrin personal dhe për numrin personal. Më vonë sigurisht do të kemi edhe një ligj që do të rregullojë çështjen e vendbanimit dhe vendqëndrimit që kanë të bëjnë me çështjet statusore të personave civil. Po ashtu edhe Ligji mbi shtetësinë e Kosovës, që besoj se do të jetë në një fazë të mëvonshme. Unë do të shtoja vetëm një vërejtje po them në Ligjin për emrin personal neni 3.4 rreth kufizimeve që parashtron ky projektligj, unë do ta lexoj në tërësi “E drejta për përcaktimin e emrit personal mund të kufizohet nëse kjo është e domosdoshme. Unë i kam futur që të dyja ligjet ,sepse gati një materie e shqyrtojnë, prandaj do të them kështu që në pjesën ku flitet për emrin personal nuk do të diskutojmë si grup parlamentar. E drejta për caktimin e emrit personal, sepse zakonisht së pari vjen emri e pastaj numri dhe këtu i kanë radhitur gabimisht. E drejta për caktimin e emrit personal mund të kufizohet: Parimisht nuk ka arsye, nuk ka shkak që mund ta kufizojë të drejtën e vënies së emrit, të drejtën e përcaktimit të emrit, thotë nëse kjo është e domosdoshme për ruajtjen e sigurisë publike. Njeriu me emër nuk rrezikon sigurinë publike absolutisht, mund të jetë një çështjen e moralit publik diçka që mund të rrezikohet, por sa i përket sigurisë publike, ju lutem nuk ka emër që mund ta rrezikojë absolutisht, ose në të drejtat dhe liritë e personave të tjerë. Emri nuk përcakton anën e brendshme subjektivitetin ose veprimin e personit. Vetëm me veprime mund të rrezikohet siguria publike, jo edhe me emër. Në Ligjin për gjendjen civile ose për gjendjes statusore vërtet aty do të ketë vend edhe për librat amë që janë, dihet cilat janë librat amë, mënyra dhe përdorimi i tyre, shfrytëzimi i tyre dhe natyrisht këto do të duhej të përfshiheshin në ligjin bazik që janë dhe të mos na vijnë dhe të fillojmë nga kulmi dhe të shkojmë në bazë, të ndërtojmë bazën dhe pastaj nga ajo bazë të nxjerrim edhe pjesë të tjera që janë të nevojshme për realizimin e këtyre të drejtave të qytetarëve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Në emër të AAK-së deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. kryetar, i nderuari z. ministër, të nderuar deputetë.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së t’i jap përkrahje miratimit në parim të këtij projektligji, duke konsideruar si një projektligj i rëndësishëm për të dhënat mbi personat qoftë qytetarë të Kosovës, qoftë qytetarë të huaj, të cilët do të fitojnë të drejtën e qëndrimit të përhershëm ose të shtetësisë së Kosovës. Të nderuar deputetë, Ministria e Punëve të Brendshme është duke bërë hapa të rëndësishëm në ngritjen e infrastrukturës organizative të Ministrisë në kuadër të secilës, është në ngritje e sipër edhe departamenti i azilit dhe azilkërkuesve që do të thotë, që Kosova përmes kësaj Ministrie po përgatitet që si shtet i pavarur t’i marrë edhe obligimet e veta të përcaktuara me konventat ndërkombëtare ndaj azilkërkuesve dhe qytetarëve të huaj të cilët kërkojnë dhe do të kërkojnë qëndrim të përhershëm dhe leje të përhershme për të jetuar në Kosovë. Numri personal ka rëndësi të veçantë për identifikimin dhe dhënien e numrit personal qytetarëve të cilët fitojnë azilin në Kosovë ose edhe e fitojnë të drejtën e qëndrimit të përhershëm në Kosovë, përveç rëndësisë që çdo qytetar i Kosovë me lindjen, me emrin dhe me regjistrimin e tij në librat amë në territorin e Kosovës, fiton edhe numrin personal. Pra ky ligj përcakton edhe të drejtën e qytetarëve të huaj të cilët kërkojnë azil dhe e fitojnë sipas rregullave, ne duhet të miratojmë këtu edhe Ligjin për azilin, ai do të vijë në Kuvend të Kosovës. Ne konsiderojmë se ky ligj është një parapërgatitje që Kosova t’i marrë obligimet edhe ndaj këtyre rasteve. Si komision më lejoni që tani të

them si kryetar i Komisionit Funkcional që do ta shqyrtojë këtë projektligj. Ne i përkrahim vërejtjet e zonjës deputete Nekibe Kelmendi, pra lus edhe Kuvendin që të na mundësojë që Komisioni Parlamentar për Siguri të ketë të lejuar një kohë shtesë për miratimin dhe për shqyrtimin e këtij projektligji. Pra ,të presim Ligjin për gjendjen civile dhe së bashku me Komisionin për Shërbime Publike t'i harmonizojmë këto dy projektligje dhe amendamentet të cilat eventualisht do t'i kishim sugjeruar në këtë projektligj. Pra në emër të Komisionit Parlamentar, dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së lus deputetët që të miratojmë në parim këtë projektligj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të Grupit Parlamentar ORA Gazmend Muhaxhiri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Edhe ne si grup parlamentar i japim mbështetje këtij ligji ose projektligji për numrin personal, mirëpo jemi të brengosur si është e mundur që Projektligji për numrin personal, Projektligji për emrin personal edhe Projektligji që duhet të vijë për regjistrin e gjendjes civile, nuk kanë ardhur në të njëjtën kohë dhe nuk janë pak kohë edhe të jenë të rregulluar edhe të amendamentuara në Qeveri. Po krijohet përshtypja se projektligjet janë duke i punuar dy qeveri dhe tri qeveri të ndryshme edhe po ia delegojnë Kuvendit pa e pasur një lidhshmëri në mes veti, edhe po paraprin kush mund me miratu një projektligj para një projektligji tjetër edhe pse Projektligji i regjistrit është dashur me u paraprirë këtyre dy projektligjeve?.

Është brengosje domethënë fakti se, Qeveria nuk po e ban harmonizimin e projektligjeve edhe prioritetet se cilat ligje vinë në pako edhe kohën kur duhet me ardhë në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit në emër të Grupit 6+ Hysnija Beshkoviç

DEPUTETJA HYSNIJA BESHKOVIC –

Hvala g.Predsedniće, poštovani ministri i kolege poslanici. Nacrt Zakona o ličnom broju još jedan u nizu zakona koje neophodan radi kompletiranja zakonskog okvira Kosova, i eliminisanje dosadašnjeg zakonskog vakuma u ovom zakonskom području.

Oblast delovanja Nacrta zakona utvrđivanja personalnog broja značenje struktura i način određivanja ličnog broja. Ovaj Nacrt zakona je neophodan za pravno uređivanje strukture i načina određivanja personalnog broja za državljane Kosova kao i za strane državljane. Nacrt zakona je predložen od strane ministarstvo unutrašnje poslova u cilju otklanjanja praznina u postojećem zakonu i u vezi sa određivanje personalnog broja. U poglavlju 6 član 12 utvrđeno je da: Ministarstvo unutrašnje poslova nadležno zavodenje evidencije u pisanom i elektronskom obliku o ličnom broju, dok je u članu 13 utvrđeno odgovornost ministarstvo unutrašnjeg poslova za nadzor nad sprovođenjem Zakona.

Nacrt zakona ima standardni oblik i strukturu koja se koristi za izradu zakonodavstva privremene institucije samoupravne Kosova i u skladu je sa Ustavnim okvirom.

Nacrt zakona ne sadrži diskriminirajuće odredbe. Razmatrajući Nacrt zakona uočili smo i izvesne nedostatke, primera radi u tekstu Zakona u članu 6, navedeno je da se lični broj upisuje počev od lične karte i nadalje pasoš i ostala lična dokumenta.

Naša primedba je da se lični broj treba početi upisivati samim rođenjem, znači otnosno izdavanjem primarnih dokumenata kao što su izvodi upisivanja u knjigu državljana.

U izradi konačne verzije Nacrta zakona o ličnom broju parlamentarna grupa 6+ daće se svoj doprinos kroz rad funkcionalne komisije i predlog amandmana te isti u načelu prihvatamo. Hvala vam na pažnji.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar. Në jetën e përditshme civile për çdo shtetas të Kosovës me rëndësi të veçantë është edhe mënyra dhe metoda e realizimit të numrit personal. Andaj ky është edhe obligim shtetëror që të rregullohet me ligj ,ashtu siç është proceduar deri më tani. Në fazën të cilën gjendemi unë mendoj se është më se e nevojshme dhe e arsyeshme .që në këtë zbrazëti ekzistuese juridike të kësaj fushe, si dhe pasojat që bartësit e shtetasit në mungesë të numrit personal mund t'i kenë. Ndonëse ligji amzë ekziston dhe mora konfirmimin se është miratuar, në mungesë të ligjit mbi gjendjen civile krijohen disa dilema se a duhet miratuar këtë .para atij, ose atë. Natyrisht për të gjithë janë të njohura procedura dhe rëndësia e ligjit bazë mbi ligjet burimore nga ligji bazë. Megjithëkëtë me rëndësi është të konstatohet se përcaktimi ligjor i procedurave për numrin personal, ndryshimin dhe plotësimin e tij si dhe pasojat që duhet të arrihen me këtë propozimligj, çdo gjë është qëllimire dhe qartë e përcaktuar në propozimligj dhe kushtet e domosdoshme të miratimit në parim të këtij propozimligji.

Detyrimisht caktimi i numrit personal, si pasojë paraqet nevojën e modifikimit të strukturave bazë të ligjeve civile, të aplikimeve dhe metodave të regjistrimit civil, kërkesave personale, si dhe të metodave të evidentimiti.

Prandaj, kjo procedure krijon shpenzime buxhetore. Nga ana tjetër nga e tërë kjo buron kërkesa se në Kosovë për shtetasit e saj sa më shpejt duhet krijuar po ashtu kushtet,duke u mbështetur në këtë në nxjerrjen e lejeve të reja të njoftimit e të dokumentacioni tjetër të udhëtimit, të patentëshoferit dhe një numër dokumentesh personale që burojnë.

I tërë ky proces administrativo - juridik kushtëzon sistemin funksional dhe paraqitjen e nevojës profesionale kadrovike të tërë asaj që do të ngërthejë në realizimin e tërë kësaj materie. Për të krijuar një sistem të atillë ku edhe qytetari do të participojë si shtetas për nderimin e numrit personal apo rregullimin e dokumentacionit ,duke krijuar një administratë sa më efikase, por kurrësi kjo vlerësoj, nuk duhet të ndodhë në vitin 2007, vit kur përgatitet apo paradiskutohet se do të organizohen zgjedhjet lokale edhe ato kombëtare, sepse në këto rrethana me problemet ekzistuese një ballafaqim i tillë i kësaj administrate do t'i shtonte përgjegjësinë dhe vëllimin e punëve. Vlerësoj se në tërë propozimligjin mbi numrin personal duhet pa tjetër termat juridikë të dominojnë dhe në veçanti ajo qytetare të zëvendësohet me shtetasit e Kosovës.

Vlerësoj se Projektligji në zbatimin e tij duhet të kihet parasysh teknikat më bashkëkohore për numrin personal, Vetëm si ide paraqes, sepse do të paraqes edhe amendament në vend të numrit personal dhetëshifror, mendoj se do të ishte mirë të aplikohet numri personal katërshifrorë dhe e dyta çdo komunë e Kosovës ta ketë indeksin e vet dallues, pastaj fillon numri personal deri në përfundim të numrit të qytetarëve të lindur, apo të vdekur që bëhen në ndrrime në regjistrat civilë. Kjo do ta pasuronte shumë ligjin e gjendjes civile dhe numrin e qytetarëve dhe do të shkurtonte shumë shpenzimet në mënyrë aproksimative për të ditur gjendjen e shtetasve të shtetit të Kosovës. Ju faleminderit, duke konstatuar që edhe unë jam që të aprovohet në parim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Meqë nuk ka më diskutues të paraqitur, lus regjinë dhe deputetët të shkojmë në votim në parim.

Votojmë tash: Në sallë kemi momentalisht 71 deputetë.

Për..... 66,
Kundër 8.

Konstatojë se Projektligji për numrin personal aprovohet në parim.

Në bazë të rregullave 23.6 dhe 35.2 Kuvendi i Kosovës ngarkon këto komisione.

Komisioni për Siguri, si komision funksional dhe referues.
Komisioni për Çështje gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatet jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligji për emrin personal.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 20 dhjetor të vitit 2006, pra janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin Rexhepi ta marrë fjalën:

MINISTRI FATMIR REXHEPI – Ju faleminderit z. kryetar. Projektligji për emrin personal po ashtu është tue u përgatitë në kuadër të pakos së projektligjeve të planifikuara, në mesin e cilave u përmenden këtu edhe disa të tjera që janë në përgatitje dhe procedim e sipër nga ana e Qeverisë. Me të drejtë ishin vërejtjet .prandaj, në kuadër të këtij projektligji për emrin personal, fushëveprimi i projektligjit, përcaktimi i kuptimit, I përbërjes dhe mënyra e caktimit të emrit personal, si dhe kushtet për aplikimin për marrjen e caktimit dhe të ndryshimit të emrit personal.

Nevoja po ashtu për këtë projektligj është rregullimi ligjor i kuptimit përbërjes dhe mënyrës së caktimit të emrit personal ,si dhe kushtet për aplikimin, ndryshimin dhe përmirësimin e tij. Projektligji ka pesë kapituj, gjithsej 27 nene duke filluar pra nga ato standard - dispozitat e përgjithshme -deri te dispozitat e fundit, në kuadër të cilave , pra

edhe e ka qëllimin e tij të përcaktojë kuptimin e emrit personal, përbërjen e emrit personal, mënyrën e përdorimit të emrit personal për komunikim juridik. Përcaktohen gjuhët e përdorura për caktimin e emrit personal, afati për lajmërimin e emrit personal, rregullohet caktimi i emrit personal për fëmijët, rregullon parimin e përfilljes së interesit të fëmijës, si dhe i caktimit të emrit personal të fëmijës nëse nuk ka marrëveshje të prindërve, pastaj përcakton rregullat, mënyrën dhe kushtet e ndërrimit të emrit personal.

Gjatë hartimit të tij Projektligji është strukturuar në kuadër të standardeve që punojnë në Qeveri, si dhe është në pajtim me konventën ndërkombëtare, pra si përvojë që është nxjerrë nga ajo lidhur me emrin personal si dhe standardet që aplikohen në këtë fushë. Për zbatimin e këtij projektligji në bazë të parallogarive pra nuk nevojiten mjete buxhetore shtesë, kështu që unë mirëpres do të thotë nga komisionet parlamentare përvojën profesionale në diskutim në vlerësim dhe në plotësimin e këtij projektligji. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër, fjalën e ka deputetja Naxhie Doçi në emër të LDK-së

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – Ju faleminderit z. kryetarë, i nderuari kryetarë i Parlamentit të Kosovës z. Kolë Berisha i nderuari kryeministër i Kosovës, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm në këtë sallë të Parlamentit të Kosovës.

T’jua them të drejtën unë nuk jam caktuar nga grupi parlamentar, por megjithatë po e lexoj si përgatitje kështu timen.

Projektligji për emrin personal është një dëshmi konkrete e punës së palodhshme dhe me përkushtim të Qeverisë të Kosovës, për rregullimin dhe begatimin e Kosovës me legjislacion më së të nevojshëm. Si domosdoshmëri për të ecur me trendët e zhvillimit dinamik të shoqërive në tranzicion . Pra, për të ecur me trendet e shoqërive demokratike me shtet- formim të shëndoshë. Konkretisht ky projektligj është rezultat i një pune me dinamizëm të përkushtueshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si ministri e re për të bërë ligje për punë të suksesshme.

Projektligji për emrin personal është i një rëndësie të veçantë dhe shumë I domosdoshëm për Kosovën si shtet në themelim se krijon atmosferë stabiliteti në një sferë të caktuar legjislative. Pra rregullon dhe përcakton kuptimin përbërjen dhe mënyrën e caktimit të emrit personal, si dhe rregullon dhe përcakton kushtet për aplikimin ndryshimin dhe përmirësimin e emrit personal. Jemi të vetëdijshëm se në Kosovë deri më tani është punuar disi për caktimin e emrit personal si dhe për aplikimin, ndryshimin, dhe përmirësimin e tij, pra është punuar me një legjislacion ekzistues të të trashëguar nga një kohë e rëndë e një pushtimi klasik mbi ne si popull.

Po një ligj i tillë duke i pasur zbrazëtitë dhe mangësitë e veta evidente assesi nuk e plotësonte si duhet dhe sa duhet interesat e Kosovës si shtet, si edhe nuk i plotësonte interesat e popullit të saj në përgjithësi. Mbi bazën e kësaj por edhe mbi bazën e materialit të bollshëm dhe kualitativ në te mund të themi se projektligji në fjalë i ka risitë dhe përparësitë e veta shumë të qarta.

Për përcaktimin e rregullave ligjore dhe për adresimin e çështjeve në këtë projektligj janë paraparë procedurat avancuese dhe kjo është edhe bindja kryesore për risitë e pa kontestueshme në te.

Risi tjetër është se edhe për hartimin e këtij projektligji është marrë si model bazë ligji slloven për emrin personal. Është marrë parasysh konventa ndërkombëtare mbi ndryshimin e emrave dhe të mbiemrave e nënshkruar në Stamboll me vitin 1958. Si risi shumë e nevojshme për ne është edhe se ky projektligj është në përputhshmëri me përmbajtjen e direktivës së Parlamentit Evropian, por edhe të Këshillit të Evropës të datës 24 tetor 1995 dhe të asaj të 12. korrikut 2002 për temat e ngjashme.

Krahas vlerësimeve për risitë pozitive në këtë projektligj kam edhe disa vërejtje që mendoj se duhet të merren parasysh gjatë amandamentimit nga komisioni funksional, si edhe nga të gjithë të tjerët që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë aspekt.

Mendoj se titulli i Projektligjit do të ishte më konkret po të emërtohej Projektligji për caktimin e emrit personal dhe për mbiemri.. Këtë e them ndër të tjera edhe mbi bazën e përmbajtjes së tekstit në nenin 4, përbërja e emrit personal, pika 1 dhe që thuhet citoj: Emri personal përbëhet nga emri dhe mbiemri, mbaron citati. Në nenin 7 paragrafi 3 ceket se emri dhe mbiemri i qytetarit shkruhen në alfabetin latin. Këtu mendoj se është bërë gabim dhe për këtë duhet të shtohet edhe një paragraf tjetër, pra paragrafi 7.4 do të jetë, emri dhe mbiemri i qytetarit shqiptar shkruhen në alfabetin e vet.

Që të konkretizohet më mirë dhe të mos ketë njëanësi në këtë aspekt mund të vazhdohet edhe paragrafi 7.5 dhe të shkruhet. Emri dhe mbiemri i qytetarëve të tjerë të Kosovës të shkruhet me alfabetin latin në gjuhën e tyre. Paragrafi pasues i këtij neni të përmirësohet sipas numrit të paragrafëve të shtuar. Gabimi në nenin 7.3 mendoj se është bërë me rastin e përkthimit të ligjit nga sllovenishtja, sepse është thënë se për hartimin e Projektligjit është marrë ligji slloven, e sllovenishtja mund të shkruhet me alfabetin latin dhe me atë cirilikë.

Edhe paragrafi 7.4 i nenit 7 është si i pa qartë sa i përket formulimit kuptimor kur thuhet nuk duhet të modifikojë formën e emrit personal me gjuhën origjinale. Në citatin e lartshënuar, (ka nevojë z. kryetar të përmirësohen disa, unë mendoj). Në citatin e lartshënuar fjala modifikim nuk është e qëlluar dhe mendoj se formulimi do të dilte më i kuptueshëm si në vijim. Nuk duhet të ndryshojë, të ndërrojë, pra për qëllim përshtatshmërie, formën e emrit personal në gjuhë origjinale. E nëse fjala modifikim është dhënë për kuptim të fjalës përkthim, atëherë edhe kjo nuk është mirë se emri origjinal ndërron, nuk mund të përkthehet në asnjërën gjuhë që flitet në Kosovë. .

Projektligji ka edhe gabime gjuhësore që shpeshherë jo vetëm që e dëmtojmë ,por edhe e çorodisin kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Sa për kureshtje po e cek p.sh. në nenin 14.2 thuhet; qytetari i moshës së mitur mund ta ndërrojë emrin personal e tjera, e duhet shkruar: Mund ta ndërrojë , se nuk është fjala për nderim te emrit personal por për ndërrim. Mendoj se me angazhimin e njohësit të mirë të drejtshkrimit do të përmirësohen gabimet e tilla dhe projektligji në fjalë, krahas vlerësimeve të tjera përkatëse kuptimore do të bëhet vërtetë një ligj i standardizuar dhe modern për përdorim.

Me shpresë të një finalizimi të tillë të suksesshëm për plotësim të dejtë të nevojave e të kërkesave të qytetarëve tonë. Projektligjin për emrin personal e përkrah në parim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Zonja Nekibe kërkoj falje , në momentin kur është dashur të paraqitet përfaqësuesi i LDK-së ka qenë vetë emri i saj në regjistër. Urdhëroni z. Nekibe.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari z. kryetarë Grupi Parlamentar i LDK-së ka të njëjtin arsyetim sikur për Ligjin për numrin personal edhe për Ligjin për emrin, prandaj nuk kam çka t'i shtoj. e mbështesim këtë ligj në parim dhe propozojmë që ta miratojë Kuvendi në lexim të parë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, PDK-ja a ka diçka?

DEPUTETI GANI KOCI- Unë e thashë në herën e parë se konsiderojmë se gati është e njëjta materie dhe si të tilla kështu do të duhej të shqyrtoheshin. Prapë, kemi të njëjtin qëndrim që të jetë një ligj i veçantë edhe për emrin personal edhe për numrin personal, dhe kufizimet që i ceka edhe më herët rreth emrit personal në nenin 3.4 të shqyrtohen me vëmendje nga komisioni adekuat, por edhe nga ne si deputetë. Pra, të shohim se si janë të rregulluara edhe në vendet e tjera kufizimet rreth emërtimeve, rreth emrave personal, por në qoftë se kemi për bazë dy dokumente evropiane, dy dokumente ndërkombëtare, direktivën e Parlamentit të Evropës të vitit 1995 dhe direktivën e Parlamentit po ashtu të Këshillit të Evropës 2002-tës e para rreth mbrojtjes së individëve sa i përket procedimit të të dhënave personale, si dhe për lëvizjen dhe liritë e tyre të dhënave. E dyta procedimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e imunitetit në sektorin e komunikimit elektronik, nuk besoj që gjeni kufizime të tilla, siç janë të përcaktuara si i ka paraparë ky projektligj.

Prandaj, kjo le të merrët si vërejtje. Vërejtje tjetër në të dy këto projektligje përdoret shprehja: Libri civil, ose libri i gjendjes civile. Nuk ka një libër civil por janë librat e gjendjes civile, prandaj si të tillë duhet të përcaktohet dhe të definohet mirë dhe të përdoret atje ku e ka vendin .ashtu siç duhet. E thashë edhe atëherë kemi libër amë të lindurve, të vdekurve, të gjendjes martesore e të tjera dhe si të tillë nuk ka libër civil. Si dokumente publike librat civilë me siguri do të rregullohen me ligje që u thanë edhe më parë, por prapë mbetemi në qëndrimin që të fuzionohen në një ligj të vetëm këto dy ligje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit, në emër të AAK-së deputeti Naim Maloku

DEPUTETI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së përkrahim miratimin në parim të këtij projektligji duke konsideruar se ky projektligj është i punuar mirë dhe i harmonizuar me ligje të tjera të bashkësisë ndërkombëtare, posaçërisht të BE-së. Kufizimet që janë të paraqitura dhe të përcaktuara në këtë projektligj në lidhje me vendin e emrit dhe me ndryshimin, posaçërisht të emrit, kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë për shkak se shumë individë kërkojnë që ose synojnë të ndërrojnë emrin, qoftë për të fshehur gjurmët ose aktivitetet t ndryshme kriminale të personit në të kaluarën dhe për të marrë emrin tjetër, apo qoftë për rastet e tjera. Pra ,këto janë të përcaktuara edhe me ligjet e shteteve të tjera rastet kur mundet personi i caktuar me ndërruar emrin dhe

me bë ndryshime, pra është e drejtë , mirëpo janë edhe disa kufizime të përcaktuara, në këtë ligj janë të përcaktuara këto kufizime dhe janë me vend.

Më lejoni të them se administratat komunale janë të stërngarkuara me kërkesat e qytetarëve për ndërrimet e emrave dhe mendoj se miratimi i këtij projektligji do të ishte me rëndësi të veçantë edhe për kufizimet dhe përcaktimet me ligj të atyre kushteve që duhet plotësuar për t'u ndërruar emrat. Ju faleminderit z.kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, në emër të ORA-s deputeti Gazmend Muhaxhiri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHIRI – Grupi parlamentar i ORA-s jep mbështetje këtij projektligji me të njëjtat vërejtje që i patëm edhe për Projektligjin për numrin personal. Besojmë se është nevojshëm për legjislacionin e Kosovës e ka mbështetjen tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ Mahir Jagcilar

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR – Ju faleminderit z. Kryetarë Sayın Meclis Başkanı, Sayın Bakanlar ve Milletvekiller

6+ Parlameter Grubu olarak biz, Kimlik Adlar Yasası'nı özel bir dikkatla görüştük. Grup olarak bu Yasa'nın, özette memnun edici olduğunu ve bu toplumsal alanın sağlıklı bir Yasa ile kapsadığını düşünüyoruz. Tam bilgiler sayesinde ve kimlik adlarının kusursuz yazılış şekliyle vatandaşlarının kayıt olması her devlet için çok önemli bir unsurdur. Bu titizlik, yaşamın her alanında kolaylıklara vesile olacak ve Kimlik Numara Yasası ile birlikte Kosova'da normal ve güvenli bir yaşamın sürdürülmesi için çok önemli bir güvence olacaktır.

Yasa Tasarısı ile ilgili bu olumlu değerlendirmelerimizden mada bu Yasa hakkında birkaç uyarımızın da olduğunu söylemek istiyorum.

Birinci uyarı olarak şunu sormak istiyorum. Bu yasayı hazırlayan çalışma grubuna üyeler listesinin açıklamadığını görüyoruz, dolayısıyla söz konusu Yasanın, tam anlamıyla isabetli olması itibariyle, çalışma grubuna ihtiyacın mı olmadığı yoksa teknik bir kusurun mu mevcut olduğunu anlayamadık.

İkinci uyarı olarak, 7.1 ve 7.2 maddesinde dillerin kullanımı ile ilgili ayan olmayan bir formulasyona işaret etmek istiyorum. Bu maddelerde kimlik adların kayıdı ile ilgili kurallarda “onun dilinde” açıklaması yapılıyor. Bunun anadili anlamına mı geldiğini yoksa başka bir anlama mı geldiğini bilmek isteriz. Bunun ayan ve ikircimsiz bir şekilde formüleştirilmesi gerektiğini düşünüyoruz.

Bu münasebetle Türk topluluğunun, kimlik adları kayıt edilirken ve kullanılırken sık sık sorunlarla karşılaştığını vurgulamak istiyorum. Bildiğiniz gibi Türk alfabesi, birkaç kendine özgü ve farklı harfi vardır. Bundan dolayı aynı sorunların tekrarlanmaması için bu konunun Yasa ile açıklanıp belirlenmesinin yerinde olduğunu düşünüyoruz. Diğer taraftan Dillerin Kullanımının ait Yasa'da da kimlik adlarına ait iki maddesi var, dolayısıyla bu iki Yasa arasında gerekli uyumluluğun yapılması gereklidir.

Biz grup olarak bu Yasa ile oldukça ilgilenmekteyiz ve bu Yasanın Meclis komisyonlarının ilerideki işlemleri süresinde, pratik kullanımı için memnun edici şeklini alacağına inanıyoruz.

Dikkatinize teşekkür ederim

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Fetah Berisha

DEPUTETI FETAH BERISHA – I nderuari z. kryetar dhe ju të nderuar ministra që jeni këtu, të respektoar kolegë deputetë.

Sot këtu në këtë seancë të Kuvendit të Kosovës kemi një shqyrtim për Projektligjin për emrin personal, të përpiluar dhe paraqitur nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës.

Kjo ministri është themeluar vonë pas kalimit të kompetencave të kësaj fushe te vendorët, por ia vlen të thuhet se Ministria e Punëve të Brendshme është ministria e parë në këtë lëmi edhe të cilën Kosova kur nuk e kishte, mirëpo si e tillë kjo ministri ka përpiluar edhe paraqitur këtë projektligj me të cilin ofrohet një zgjidhje mjaft e avancuar. Në këtë lëmi kjo vërehet sidomos në procedurat paraprake të emrit personal dhe në mënyrën e aplikimit për emrin personal. Kosova ka nevojë të madhe për këtë ligj dhe ky ligj është i një rëndësie mjaft të veçantë, ngase intersi i qytetarëve të Kosovës, pra emri i tyre personal lidhet me jetën praktike dhe administrative. Pra, rëndësia e këtij ligji ka të bëjë me stabilitetin legjislativ në këtë lëmi, po ashtu ky projektligj ka lidhmëni edhe me ligjin për numrin personal me ligjin mbi familjen, dhe qendrën e punës sociale, pastaj me ligjin për gjendjen civile e të tjerë. Me qëllim që ky projektligj ta ketë formën e strukturës së standardeve ndërkombëtare, është marrë parasysh edhe modeli i ligjit slloven për emrin personal, mandej konventa ndërkombëtare për ndryshimin e emrave dhe mbiemrave mbështetur në Kornizën Kushtetuese tjera. E gjithë kjo që ka ky Projektligj të krijojë përshtypjen se qëllim i këtij ligji është që të krijojë stabilitet ligjor edhe në lëmin të cilin rregullon. Natyrisht se ky Projektligj nuk është i përsosur si i tillë ka edhe mangësitë e veta. Unë mund të përmendë vetëm nënin 26 pastaj nënin 2 paragrafi 4 të formulohet sërish ma mirë se ka edhe gabime të ndryshme gjuhësore se fjalitë e këtij neni çalojnë. Mirëpo, edhe për mua këtu është një dilemë dhe na del një dilemë në mes këtyre dy projektligjeve edhe numrit personal edhe të emrit personal. Mirëpo duhet pasur parasysh se te dy këto ligje kanë specifikat e veta, prandaj fjalën e fundit për këto dy ligje e kanë profesionistët, juristët, të cilët me siguri edhe do ta zgjidhim këtë dilemë. Megjithatë këtë projektligj duhet pranuar në parim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, meqë nuk ka kandidatë tjetër, për diskutim, lus regjinë të përgatitet për votim në parim të Projektligjit për emrin personal. Votojmë tash.

Në sallë janë 74 deputetë

Për 68

Kundër..... 3

Kalon, miratohet Projektligji për emrin personal në parim.

NË bazë të rregullave 23.6 dhe 35.2, Kuvendi i ngarkon këto komisione

Komisioni për Siguri si komision funksional dhe referues,
Komisioni për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe
Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Të nderuara deputete dhe deputetë!

Po fillojmë pjesën e pasditës të seancës së sotme, në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për siguri në komunikacion rrugor, e shtyrë nga seanca e 14 dhjetorit 2006. Miratim i parë i këtij ligji është bërë më 16 mars 2006, shqyrtimi i dytë i këtij Projektligji ka filluar me 14 dhe 18 dhjetor 2006. siç e dini edhe nga seanca e kaluar, kemi pasur paqartësi lidhur me mënyrën se si do ta miratojmë ligjin, janë mbajtur tri takime të Kryesisë lidhur me këtë çështje, është mbajtur edhe një konsultë sot, e kryetarit të Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare, dhe kanë arritur në pajtueshmëri të përbashkët, për mënyrën e miratimit të këtij Projektligji.

Për tu deklaruar para Kuvendit, lidhur me mënyrën e marrëveshjes për miratimin e këtij ligji, ua japë me radhë përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Sipas radhës fjalën ia japi kryetarit të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI - Ju faleminderit zoti kryesues, ashtu siç thatë Ju, shefat e grupeve parlamentare së bashku me kryetarin e Kuvendit, kemi arritur marrëveshje që, fillimisht me votë formale të merret ky vendim, që këto nene të sistematizuara në katër grupe të votohen, si të tilla amendamentet shkojnë në Komisionin funksional, i cili së bashku me hartuesin do të inkuadronte amendamentet dhe spastronte tekstin, në rast nevojë përveç amendamenteve të votuara këtu, Komisioni mundet me i propozua seancës plenare edhe ndonjë amendament, edhe ai tekst i spastruar vjen në seancë plenare që të votohet ligji si ligj, i përpunuar në tërësi dhe pastaj të shkon në nënshkrim të Kryetarit të Kosovës, respektivisht i Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, në emër të grupit parlamentar, të Partisë Demokratike fjalën e ka zoti Gani Koci.

DEPUTETI, GANI KOCI - Ju faleminderit zoti kryesues,

Marrëveshjet në mes grupeve parlamentare gjithkund po, edhe te ne ndonjëherë janë më të madha se sa vetë rregullat që i kemi shtrua në këtë Kuvend, dhe është mirë që është arritur një marrëveshje e tillë, në parim grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, me 14 dhjetor në seancë, ka kërkuar që vërtetë amendamentet të shqyrtohen një për një, por meqë është gjetur një solucion i tillë që, të miratohen grupet e amendamenteve dhe si të tilla të inkorporohen në tekstin e spastruar, me mundësinë e ndonjë ndryshimi eventual dhe të na sillen sërish në Kuvend, për të miratuar ligjin në

tërësi, ne si grup parlamentar e mbështesim këtë marrëveshje dhe këtë formë të miratimit të këtij Projektligji.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit zoti Koci,
Në emër të AAK-së, në deklaram zoti Naim Maloku,

DEPUTETI, NAIM MALOKU- unë nuk kamë çka të shtoj zoti kryesues, nga ajo që e thanë parafolësit e mi, pra shefi i grupit parlamentar të LDK-së, dhe në emër të PDK-së zoti Gani Koci, unë isha prezent në harmonizimin e qëndrimeve të grupeve parlamentare lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, dhe ju lus që të procedohet me votimin e grupeve të amendamenteve. Ju faleminderit!

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit,
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë ORA, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija,

DEPUTETJA, TEUTA SAHATQIJA - Ju faleminderit zoti kryesues,
në seancën e kaluar ,në të cilën është shqyrtua ky projektligj, grupi ynë parlamentar, ka qenë kundër votimit në pako, në atë mënyrë si është votua më 14....

Atëherë kemi deklarua që, ligji e ka rëndësinë e veçantë dhe si i tillë duhet të kalojë, por gjithsesi duhet që Rregullorja të zbatohet. Prej Rregullores e dimë që rregulla 37.2. thotë që shqyrtimin e dytë, pika e dytë e cila flet për shqyrtimin e dytë të projektligjeve thotë- Amendamentet shqyrtohen veç e veç sipas radhës që paraqiten në tekstin e projektligjit ,përveç nëse ndonjë grup i amendamenteve ka ndikim dhe veprues në nenet tjera. Ky ndikim veprues mund të jetë p.sh. diku, shkruan Parlamenti, edhe me një votim në të gjitha vendet, në 200 vende, ku paraqitet fjala Parlament duhet të thuhet Kuvendi i Kosovës. P.sh. në qoftë se dëshirojmë që, këto amendamente të votohen në paketë, as ajo nuk është e pamundshme, sepse Kuvendi ka të drejtë që tash të shmanget prej Rregullores, por për t'u shmangë prej rregullores, duhet të votojnë dy të tretat e deputetëve dhe në atë legjitimohet ai ndryshim.

Në seancën e kaluar, në të cilën është diskutua për këtë ligj, nuk jam e sigurt që u morën parasysh që dy të tretat e deputetëve të votojnë për këtë, prandaj grupi ynë parlamentar nuk ka asgjë kundër këtij ligji, por mendojmë që çdo punë që të vazhdon ky Kuvend duhet të vazhdojë sipas një rregulloreje të cilën ne vetë e kemi këtu. Prandaj pas këtij takimi që e patëm ne sot, diskutuam edhe në grupin tonë parlamentar, dhe mendojmë që në qoftë se dëshirojmë më shpejt të procedojmë këtë ligj, do të duhej që të shkohet nën për nen. Është varianti i parë, varianti i dytë përsëri mendoj që vetë votimi në grup, ka pasur arsyen që ky ligj të procedohet më shpejt, në fakt ai votimi grupor vetëm që e ka shty këtë ligj dhe tash në vend se të votojmë një nga një dhe ta kemi atë ligjin jemi në vaz, që duhet të zgjatet edhe më tepër.

Prandaj, në qoftë se dëshirojmë të vazhdojmë me këtë ligj, do të duhej të legjitimohet me 2 të tretën që, të shkojë në formë grupore dhe në Komision parlamentar funksional, mund të shkojë vetëm në qoftë se, Komisioni deklarohet që ka edhe ndonjë grup tjetër të amendamenteve, të cilat shtohen, përndryshe me legjitimimin e largimit prej rregullores, mendoj që sot ky ligj do të mund të procedohet dhe në fund të ditës ta kemi ligjin e miratuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit,
Zoti Xhezarir Murati në emër të Grupit Parlamentar 6+,

DEPUTETI, XHEZAIR MURATI - Hvala gospodine predsedavajuće,
Poštovani ministri kolege, mi u parlamentarnoj grupi 6+, podržavamo ovaj dogovor ili kvalifikacije između dveju najvećih partija, po ovom pitanju, samo po ovom pitanju i mislim da je ovakav način dogovora kako je napravljen u ovom slučaju, možda i modus da ćemo nekada još zbog efikasnosti bržeg donošenja, s obzorim da kasnimo u usvajanju nekih zakona, da ovo može biti primer da možemo nekada da u međuvremeno i da dođemo do sporazuma, stoga mi u grupi 6+ podržavamo ovakav dogovor, dveju najvećih partija, i mi smo za to da se na ovaj način ovaj puta, podeljen ovaj zakon u četiri grupe, dakle u paketu usvojih. Hvala vam puno!

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Hvala!
Për fjalë është paraqitur deputeti Gjergj Dedaj, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim.

DEPUTETI, GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë zoti kryesues,
Grupi Parlamentar për Integrim edhe në takimin e sotëm që kishim me kryetarin e Kuvendit dhe me përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare, në parim i kemi dhënë mbështetje, por edhe tash në seancë i mbështesin paraqitjet dhe propozimet e shefave dhe të përfaqësuesve të grupeve të tjera parlamentare dhe Grupi Parlamentar për Integrim do ta mbështes, do ta votojë dhe mund ta qetë në procedim e sipër. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, zoti Ramadan Kelmendi a e keni kërkuar fjalën?

DEPUTETI, RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues,
Të nderuar ministra, deputetë të nderuar, unë e mora fjalën sepse jam një ndër ata që kanë parashtruar, gjegjësisht kam paraqitur disa amendamente dhe mund të them atë që, vërtet e ndiej dhe e kuptoj se edhe unë pajtohem me marrëveshjen e arritur në mes kryetarëve të grupeve parlamentare, por kërkoj që vërtet të inkorporohen edhe dy amendamente të miat, që nuk janë inkorporua, por janë paraqitur me kohë dhe më datën 20, ashtu siç e parasheh Rregullorja mbi amendamentimin e ligjeve. Kërkoj që nga Komisioni i cili shqyrton këto, t'i shqyrtojë, sepse Komisioni funksional të gjitha i ka refuzuar dhe kam shumë argumente se refuzimet janë të pabaza. Ju faleminderit!

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit zoti Kelmendi,
Siç u pa nga diskutimet shumica absolute e deputetëve, gjegjësisht shefat e grupeve parlamentare, janë që të respektohet marrëveshja. Unë e kam parasysh Rregulloren, por mendoj që nga konsultat që janë bërë edhe me komisionet përkatëse edhe me sponsorizuesin e ligjit edhe me sponsorizuesit e amendamenteve, është konstatuar se të gjitha kontradiktat lidhur me këtë ligj, që kanë qenë të shprehura përmes amendamenteve, janë hequr gjatë punës që është bërë në komisionet përkatëse dhe marrëveshja e sotme, besoj që më lejon t'i hedh në votim tri grupet e amendamenteve dhe dy amendamentet përkatëse, të cilat nuk kanë ardhur për shqyrtim këtu, pastaj Komisioni edhe një herë pasi që të rregullohet, të harmonizohet teksti, në qoftë se e sheh të rrugës mund t'i sjellë në Parlament, për t'u votuar.

Atëherë po fillojmë votimin, lidhur me grupin e parë të amendamenteve të Komisionit funksional që janë nga amendamenti 1, deri në amendamentin 239, gjithsej janë 182, amendamente të propozuara nga Komisioni funksional.

A hapim votimin, teknika bëhemi gati për votim, hapeni votimin ju lutem, a është hapur votimi te ju?,

Votojmë tash: Prezent në sallë janë 75. deputetë. A ka ndonjë deputet që nuk e ka kartelën me veti dhe do me votua? Nuk ka .Të gjithë janë me kartela, atëherë konstatoj që:

PËR.....	71
KUNDËR.....	2
ABSTENIM.....	2

Konstatoj që grupi i parë i amendamenteve të Komisionit funksional, u miratua.

Vazhdojmë me grupin e dytë të amendamenteve të përbashkëta të Komisionit Funksional dhe të atij për Buxhet dhe Financa, që janë gjithësej 49 amendamente dhe fillojnë nga neni 30 deri në nenin 224.

E hapim votimin, votojmë tash:

Konstatoj që:

PËR.....	73
KUNDËR.....	2
ABSTENIM.....	3.

Është miratuar edhe grupi i dytë i amendamenteve të përbashkëta të Komisionit Funksional dhe atij për Buxhet dhe Financa.

E hedh në votim grupin e tretë të amendamenteve, të deputetit Ramadan Kelmendi, që janë amendamentet: 18, 35, 40, 45, 168, 169, 211, 220, 240, 241, gjithëset dhjetë amendamente, të cilat nuk e kanë përkrahjen e Komisionit Funksional dhe kanë mbetur që të harmonizohet, i hedhim në votim edhe këto

Votojmë tash: - Të nderuar deputetë, konstatoj që grupi i tretë i amendamenteve të propozuara nuk miratohet. Për refuzimin e amendamenteve kanë votuar

PËR.....	31
KUNDËR.....	38
ABSTENIM.....	6

Vazhdojmë me miratimin e grupit të katërt të amendamentit, që është amendamenti 242, që ka gjithësej 116 nën-amendamente dhe që prej tyre vetëm amendamenti 2 nuk ka përkrahje prej Komisionit Funksional.

Votojmë tash: Hapeni votimin, - konstatoj që, miratohet grupi i katërt i amendamentit 222,

PËR.....59
KUNDËR.....9
ABSTENIM.....7

Konstatoj që Kuvendi me shumicë votash, përkrahi amendamentet e propozuara, ndërsa teksti ka mbet të harmonizohet në komisionet përkatëse. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës që është

9. Shqyrtimi i Projektplanit hapësinor të Kosovës 2005 – 2015 (pikë e shtyrë nga seanca e 14 dhjetorit 2006)

Në pajtim me nenin 11.6 të Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 2003/14, Qeveria ka përgatitur dhe Kuvendit i ka dorëzuar për miratim, draft-planin hapësinor të Kosovës 2005-2015.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional, nuk i ka paraqitur rekomandimet e veta, por mund të deklarohet në seancën plenare.

Ftoj ministrin Ardian Gjini që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë draft-planin hapësinor të Kosovës 2005-2015.

Zoti ministër e keni fjalën

MINISTRI, ARDIAN GJINI – Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës!

Kosova edhe më përpara ka pasur plane hapësinore, ose të përgjithshme ose parciale, për të gjithë ata që kanë pasur rastin t'i lexojnë, kanë mundur ta vërejnë një veçanti, një specifikë në atë kohë, se shumica dërrmuese e atyre planeve, janë punuar nga institute jashtë Kosovës. Gjithmonë titullarë kanë qenë institutet të cilat kanë ardhur përkohësisht në Kosovë, që përkohësisht i kanë njohur rrethanat në Kosovë dhe analizat e të cilëve, janë bazuar më shumë, në përshkrimin e gjendjes dhe në evidentimin e defekteve, sesa në planifikim real dhe afatgjatë. Duke thënë këtë, dëshiroj që para së gjithash, t'i falënderoj gjithë ata deputetë që kanë qenë në thirrjen e kaluar të Kuvendit dhe Kuvendin e kaluar, e posaçërisht ish- ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Et'hem Çeku, për një vendim shumë të drejtë dhe shumë largpamës, për themelimin e Institutit për Planifikim Hapësinor në Kosovë, në mënyrë që, planifikimi hapësinor në Kosovë, jo vetëm tash, por edhe në të ardhmen, si dhe përcjellja e gjitha planeve dhe nën-planeve, të cilat do të rrjedhin, do të bëhet në Kosovë dhe nga njerëzit e Kosovës.

Dy janë, benifitet më të mëdha nga ai vendim, përpos atij që e thashë se plani bëhet në Kosovë, i pari është se ngritën kapacitetet tona, planifikuese, njerëzit tanë, ekspertët tanë, kanë fituar përvojë të mbështetur nga shumë agjenci ndërkombëtare të cilat do t'i përmend më vonë. Në të njëjtën kohë ky plan hapësinor, në një mënyrë është shndërruar edhe në pronë të qytetarëve të Kosovës, të institucioneve të Kosovës, të shoqërisë civile dhe të të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në takime dhe në konsulta të shumta deri sa ka arrit në këtë pikë.

Është e vërtetë se plani, çdo plan, çdo planifikim, ka të bëjë edhe me shijen, është e vërtetë që plani hapësinor i Kosovës ndikohet nga njerëzit të cilët punojnë në te, mirëpo nëse ky do të quhej një defekt, atëherë është synuar që përmes këtyre konsultave, përmes përfshirjes sa më të madhe të njerëzve në procesin e planifikimit dhe të konsultimit, këto defekte të eliminohen.

Ka mundësi që të ketë edhe defekte të cilat kanë qenë të paanashkalueshme në këtë fazë, por që janë plotësisht të riparueshme, do ta përmend vetëm një sa për ilustrim, është regjistrimi i popullsisë, i cili na pret, mirëpo, planifikimi që ka ndodhur gjer më tani lejon që shumë lehtë të kalohet në përmirësime nëse ato do të jenë të nevojshme. Në këtë fazë ne mendojmë se nuk do të jenë të nevojshme.

Instituti për Planifikim Hapësinor është përkrahur nga Instituti për Studime të Zhvillimit Urban dhe Banim nga Roterdami dhe po nga UN- Habitat, gjatë gjithë kohës së punës.

I ka marrë para sysh disa çështje të cilat është deshtë të rregullohen në Kosovë dhe unë do të kaloj sa më shkurt që të mund, meqenëse ju e keni marrë planin hapësinor, do t'i shpjegoj në mënyrë tjetër të gjitha ato.

Janë 12, çështjet të identifikuar nga lista e madhe e problemeve, të cilat janë trashëguar në Kosovë, me vite dhe me dekada dhe të cilat kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Është shkalla e lartë e papunësisë dhe në rritje të vazhdueshme, plani hapësinor i Kosovës detyrimisht që duhet ta ketë parasysh këtë element, për shkak se do të ndikojë drejtpërdrejtë edhe në uljen e shkallës së papunësisë, ku do të kalojë edhe më vonë. P.sh. me ruajtjen e tokës bujqësore, ose me shpërndarjen e drejtë të zhvillimit të mosgrumbullimin e punëtorëve të pa punë në qendra të mëdha. Është varfëria e lartë në Kosovë, varfëri që e kemi trashëguar dhe cila presim që, përmes politikave të cilat do të zhvillohen prej këtij plani do të ndihmojë ose do të ndikojë prapë drejtpërdrejtë të ulët, prapë në të njëjtën mënyrë, me zhvillimin e infrastrukturës së drejtë, me zhvillimin e qendrave të ndryshme në Kosovë, jo vetëm të një qendre, në ruajtjen e tokës bujqësore dhe në ruajtjen shfrytëzimit afatgjatë të resurseve të tjera.

Është humbja e tokës bujqësore, që është element shumë i rëndësishëm, në gjithë planin hapësinor të Kosovës dhe është diçka që besoj se duhet të na brengosë, secilin prej nesh, meqë secili prej nesh të mendoj për rrugët të cilat do të gjinden bashkërisht në të ardhmen. Humbja e tokës bujqësore ndodh për shumë arsye, nuk është vetëm erozioni, është edhe çështje kulturele, në kontestin negativ, që nuk e përcjell vetëm Kosovën, për do të kisha thënë gjithë Evropën Lindore, Juglindore dhe pjesë shumë të mëdha të tjera të Evropës, e që ka të bëjë me fragmentimin e tokës.

Ekzistojnë vetëm pak vende në Evropë, ku si traditë toka trashëgohet vetëm nga një pasardhës, në atë mënyrë, ajo ruhet, ruhet si parcelë e madhe, në vendet e tjera toka fragmentohet te pas-ardhësit edhe kur kalojnë gjenerata pasardhësisë, ajo tokë shndërrohet në vend të arave, në kopshte. Ndërsa, kur vazhdon edhe me tutje në vend të kopshteve detyrimisht ku janë parcelat shumë të vogla do të shndërrohet edhe në tokë ndërtime. Për ta evituar një mundësi të tillë, ekzistojnë disa rrugë, ne i kemi paraparë zhvillimet e mundshme, do të tentojmë të inkurajojmë bashkimin e tokave, jo vetëm

përmes blerjes, mirëpo edhe përmes punës së përbashkët. Shumë të lidhura me këtë janë edhe banimi i shpërndarë i lokaliteteve dhe qasja e vështirësuar në rrugë dhe në trafik.

Kosova ka numrin më të madh të vendbanimeve, qofshin të vogla apo të mëdha, për sipërfaqe do të thotë relative. Vendbanimet nuk mund të evitohen, ato kanë ndodhë, ato ekzistojnë, do të jetë një punë e vështirë e të gjithë neve, që ato vendbanime t'i lidhim me rrugë të asfaltuara, me kanalizim, me ujësjellës, me trajtim të ujërave të zeza, me telefon, me energji elektrike dhe me të gjitha shërbimet e tjera të cilat janë të nevojshme. Mirëpo nëse, planifikimi është i gjithmbarshëm, nëse i qasemi planifikimit, duke e shikuar në tërësi, atëherë kostoja e këtij planifikimi, kostoja e ofrimit të gjitha këtyre shërbimeve, do të jetë ndjeshëm më e ulët se kostoja e cila do të ndodhte, nëse planifikimi do të ishte i lënë në vetvete.

E përmenda kualitetin e ulët, do të thotë kemi kualitet të ulët të shërbimeve. Mirëpo jo vetëm këto që i përmenda, janë edhe shërbimet shëndetësore dhe arsimore. Ku hyn plani hapësinor i Kosovës, në shërbimet arsimore dhe shëndetësore, është shumë e qartë që kemi shumë shkolla nëpër Kosovë dhe duhet të ketë, mirëpo duhet të tentohet që ato shkolla të kenë shërbime sa më të mira, të ofrojnë arsimim sa më kualitativ, që do të thotë se ndoshta, ky plan do t'u ofrojë mundësi komunave të shikojnë mundësinë e grupimit, të paktën të shkollave të mesme, në mënyrë që, në shkolla më të mëdha, nxënësit të kenë kabinete, të kenë biblioteka dhe të mos kemi shkolla vetëm me dy klasë ku do të jetë prapë tejet e kushtueshme, që t'i ofrojmë të gjitha këto shërbime.

Zhvillimi i pabarabartë ekonomik ndërlidhet me të gjitha këto që i thashë, është një qëllim, ka qenë qëllim i planit hapësinor të Kosovës, që të mos bazohemi në zhvillimin e një nyje që është vetëm Prishtina, por të bazohemi në zhvillimin e shumë qendrave, d.m.th. në një zhvillim policentrik në Kosovë, i cili do t'u ofronte mundësi qendrave të ndryshme të Kosovës, që të kenë karaktere të ndryshme zhvillimore që, të mos i konkurrojnë njëra-tjetrës në hapësirë, por që ta ndihmojnë zhvillimin e njëra-tjetrës.

Ka pasur elemente të shkatërrimit sidomos të trashëgimisë natyrore, por edhe të asaj kulturore dhe përmes planifikimit dhe përmes ndarjes, tek e cila do të vijë më tutje synohet prapë, që ajo trashëgimi të kultivohet, të ruhet dhe në të njëjtën kohë të jetë në shërbim të njerëzve, qoftë për rekreacion, për kulturë e aktivitete tjera. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore është diçka që, përcjell Ministria e Mjedisit vazhdimisht edhe prapë i njëjti element gjendet edhe në planifikimin hapësinor të Kosovës, për shkak se, një kujdes i shtuar do të na lejojë që pasuritë të cilat i kemi t'i shfrytëzojmë në mënyrë sa më të gjatë dhe në mënyrë sa më racionale.

Ekziston si problem edhe shkalla e lartë e ndotjes dhe degradimit të mjedisit, prapë është një problem të cilin e kemi trashëguar dhe i cili është krijuar si problem për dekada të tëra të mosplanifikimit të shfrytëzimit të resurseve. Edhe kjo është çështje e cila përmendet në plan dhe zonimi i cili ka ndodhur në plan. Format e rregullimit të rrugëve dhe të shfrytëzimit të resurseve, merren thellësisht edhe me këtë problem. Janë edhe zonat të cilat janë të rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni. Mendoj se nuk ka nevojë t'ju përmend se kemi pasur edhe probleme serioze, në këtë drejtim dhe prapë si problem, i identifikuar dhe si i 12-ti prej problemeve më kryesore, është trajtuar, do t'ju përmend vetëm edhe formën e zonimit të shtatë qendrave të mëdha në Kosovë, e cila në planin hapësinor të Kosovës është shënuar në formë metaforike dhe mendoj se edhe në atë

formë metaforike është shumë e kuptueshme për deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe për gjithkënd, e kemi quajtur -

Thesari i Kosovës – një pjesë e cila është regjioni i Mitrovicës ngjyra e gjelbër – (Mitrovica) që në fakt paraqet pasurinë më të madhe nëntokësore, është pasuria më e madhe nëntokësore e Kosovës e koncentruar në atë rajon, e kemi

Porti i Kosovës – ngjyra e kaltër – (Prishtina) paraqet një kryesore hyrëse dhe dalje të Kosovës afër së cilës kryqëzohen korridoret kryesore rrugore;

Urat e Kosovës – ngjyra e verdhë – pjesa juglindore (Gjilani dhe Ferizaj) dhe pjesa perëndimore (Gjakova) në fakt paraqesin zonat që luajnë rolin e urave lidhëse të Kosovës dhe rajoneve që janë afër dhe që varen ekonomikisht nga ky bashkëpunim, të pasura gjithashtu me sasi të mjaftueshme të tokës kualitative bujqësore; dhe

Kopshtet e Kosovës – ngjyra portokalli – pjesa jugperëndimore (Prizreni) dhe pjesa veriperëndimore (Peja) – me përmbajtjet e veta Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna paraqesin kopshtet dhe njëherit trashëgiminë kulturore dhe historike të të gjithë Kosovës.

Çka nëse nuk ndërmarrim asgjë?

Nëse nuk zbatohet planifikimi për një shfrytëzim racional të hapësirës dhe nëse vazhdon trendi i zhvillimit të ulët e të pabarabartë ekonomik, do të kemi pasoja negative, të grupuara e të reflektuara në aspekte të ndryshme: social, ekonomik dhe mjedisor.

Vendbanimet/qytetet e mëdha do të vazhdonin trendin e rritjes së tyre të paplanifikuar, me rritje të zhvillimeve joformale e cila do të rezultojë me kosto të lartë të investimeve në infrastrukturë fizike dhe në shërbime e me pamundësinë e veprimit sinergjik. Trendi i migrimit drejt qendrave të mëdha do të vazhdonte, ndërkaq mungesa e hapësirave për banim me qasje dhe kushte të volitshme do të bëhet problem edhe më i madh, i shoqëruar edhe me implikime të problemeve të punësimit, shkollimit, transportit, shërbimeve të tjera komunale me ato të natyrës institucionale si problemin e të dhënave të pasakta për vendqëndrim, taksapagimeve, shfrytëzimit joracional të tokës, pabanueshmërinë e pronave të braktisura.

Investimet edhe ashtu të pakta sektoriale e kapitale janë në disfavor të zhvillimit të barabartë hapësinor e ekonomik në Kosovë, përderisa investimet në shërbime publike nuk po mund të ndjekin trendin e nevojave aktuale për shkak të fluksit të tillë të zhvillimeve të paplanifikuara, e për më tepër të joefikasitetit të qeverive lokale.

Vazhdimi i trendit të zhvillimeve të pakontrolluara sjell ngushtimin e arterieve kryesore për lëvizjen normale brenda dhe jashtë Kosovës, kosto së rritur të transportit civil dhe të mallrave, qasje të vështirësuara me implikime në stagnim ekonomik të vendit, izolimit në rajon e për më shumë situatë të disfavorshme, meqë e ardhmja e Kosovës varet në mënyrë kritike nga aftësia e saj për t'i hapur kufijtë dhe për të përfituar nga përparësitë e saj konkurruese.

Për shkak të mungesës së strategjive të qëndrueshme e efikase për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e resurseve, do të pasonte shfrytëzimi joracional i hapësirës, humbja e tokës bujqësore, humbja e pakthyeshme e resurseve natyrore, pyjeve, ndërsa vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore do të degradoheshin dhe do të silleshin në kufijtë kritikë të funksionimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Në fund, Plani Hapësinor për Kosovën paraqet përmbledhjen e përgjigjeve në çështjet e identifikuar, në bazë të parimeve dhe të qëllimeve të caktuara, në formë të rekomandimeve, të udhëzimeve për veprime për një zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë.

Publikimi i Planit shënon fillimin e procesit për zhvillimin hapësinor në afat prej 10 vitesh. Procesi do të monitorohet dhe rishikohet në periudha të caktuara për të reflektuar ndryshimet të cilat do të mund të adresohen, e të cilat duke pasur implikime hapësinore do t'u japin mundësi për adresim të çështjeve dhe mundësive të reja për zhvillim të mëtutjeshëm. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. ministër. Tani po fillojmë me diskutimet lidhur me ligjin. Sipas Rregullores, kryetarët e grupeve parlamentare e kanë fjalën. Z. Alush Gashi në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar e ka marrë me kohë këtë dokument i cili teknikisht edhe nga përmbajtja duket që është punuar me shumë kujdes, është një prej projektligjeve shumë të rëndësishme për vendin tonë.

Ne kërkojmë nga z. ministër që këtë material t'ua përcjellë komisioneve. Në komisionet nga fushat e ndryshme të kemi mundësi që ta japim kontributin tonë dhe pastaj të kthehet për miratim në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Faleminderit. Për fjalë është paraqitur në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Selviqe Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë.

Strategjia e planifikimit hapësinor për Kosovës që na është afruar neve deputetëve për shqyrtim dhe aprovim dominohet nga elementet e strategjisë zhvillimore, nacionale dhe më pak përmban elementet e një planifikimi të mirëfilltë hapësinor të Kosovës, gjë që do të duhej të ishte e kundërta. Veç kësaj, planifikimit hapësinor është dashur t'i paraprijë strategjia nacionale e zhvillimit përmes të cilës do të përcaktohen kahet të zhvillimit ekonomik të vendit e më pastaj të bëhet planifikimi sipas sektorëve apo lëmenjve se kah do të zhvillohet Kosova në aspektin ekonomik në të ardhmen.

Përveç kësaj kam edhe një vërejtje teknike në material, sepse këtu në legjendat të faqeve këtij materiali jepen shpjegime, ngjyra e verdhë, ngjyra e kaltër, ngjyra e gjelbër, ngjyra e kuqe, është dashur që të bëhet një printim me ngjyra ,në mënyrë që më lehtë të mund të dallojmë hapësinat të cilat janë paraqitur në formë të tabelave apo hartave në këtë material.

Çështje tjetër është, ministri në ekspozenë e këtij materiali thotë: se ka penguar mosregjistrimi i popullsisë dhe kjo është një pengesë shumë e madhe ,pa dyshim, mirëpo, fakti se mosregjistrimi i popullsisë nuk do të ndikojë apo do të ndikojë fare pak në ndryshimet e planifikimit hapësinor, unë mendoj se nuk qëndron.

Strategjia e planifikimit hapësinor që na është ofruar këtu kryesisht bën një përshkrim mbi bazën e të dhënave të vjetra, siç është edhe numri i banorëve, edhe shkalla e natalitetit të popullsisë, pastaj shkalla e ndotjes qoftë të ajrit, të ujit apo tokës, të dhënat

mbi sizmitetin dhe ndryshimet klimatike në Kosovë, hapësirat e tokës së punueshme të cilat kanë humbur pas luftës shumë dhe një ç'orientim i zonave urbane gjegjësisht zonave të vendbanimit, nuk kemi të dhëna të sakta dhe nuk mund të kemi pa zhvillimin e pa strategjinë e zhvillimit ekonomik orientimet apo kahet dhe përcaktimin e zonave të zhvillimit industrial. Gjithashtu, nuk kemi të dhëna as për resurset ujore në Kosovë, se a është duke u ulur niveli i ujërave në Kosovë apo është duke u rritur.

Të gjitha këto elemente e bëjnë një strategji të planifikimit vështirë të realizueshme. Unë mendoj se deri tash ne kemi pasur Ligjin për planifikimin hapësinor dhe Ligjin për ndërtim që Ministria e Planifikimit Hapësinor shumë pak i ka kushtuar kujdes mbikëqyrjes së aplikimit të këtij ligji, që ka shkaktuar një kaos të vërtetë urbanistik jo vetëm nëpër qytete, por edhe nëpër fshatra.

Andaj, mendoj se qysh në momentin e aprovimit apo pas momentit të aprovimit të këtij planifikimi hapësinor, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor duhet me një shkresë urgjente t'u drejtohet të gjitha kuvendeve komunale që të ndërpresin ndërtimet derisa të bëjnë në vija të trasha ,sepse projektet detale e kanë vështirë ta bëjnë njëherë për njëherë, në vija të trasha të bëjnë përcaktimin e zonave të banimit dhe të zonave industriale, me qëllim që të bëhet pak a shumë, në këtë kaos, një ndërprerje e humbjes së tokës së punueshme, gjegjësisht tokës bujqësore dhe një orientim pak më i mirë i zonave industriale.

Çështje tjetër që vlen për të ngritur është se në materialin që na është ofruar shumë shpesh përmendet Prishtina si kryeqytet me specifika të veçanta. Pikërisht kjo Ministri e Planifikimit Hapësinor selinë e saj e ka në Prishtinë dhe asnjëherë s'ka ngritur zërin apo nuk ka zhvilluar kontakte me Kuvendin Komunal të Prishtinës me qëllim të parandalimit të kaosit urbanistik në Prishtinë.

Derisa Kuvendi komunal i Prishtinës lutet që të bëhet numri i banorëve një milion në kryeqytetin e Prishtinës, planifikimi hapësinor nuk parasheh që brenda 10 viteve, domethënë, ky planifikim që është ofruar që do të krijohet mundësi për një banim konform standardeve për një milion banorë në qytetin e Prishtinës. Andaj këto janë dy kundërthënie mes një programi komunal dhe një programi qeveritar. Andaj këto gjëra duhet t'i eliminojë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

Ne këtë dokument që e kemi më tepër do ta përdorim nesër si dokument se ne në Kosovë kemi planifikim hapësinor, kurse në raport me realitetin për zbatim është shumë larg. Këtu kemi hasur momente ku thuhet se planifikimi hapësinor do të rishikohet çdo 5 vite apo do të monitorohet implementimi i tij.

Kurse flitet për një planifikim prej vitit 2005 deri në vitin 2015. Sa do të revidohen dy vite që shkuan. Kur do të dalë strategjia zhvillimore nacionale e cila do të bëhet pengesë. Më pastaj edhe përkundër faktit se këta kanë bashkëpunuar gjatë hartimit të këtyre dy projekteve, mirëpo e kundërshtojnë njëri- tjetrin.

Është çështje tjetër se nuk kemi kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhet rishikimi dhe ndryshimi ,sepse sikurse edhe ligjet që po na duhen shumë shpejtë të fillojmë amendamentimin e plotësimin e tyre, edhe këtë planifikim do të na duhet shumë shpejtë ta rishikojmë dhe ta ndryshojmë.

Këtu në këtë material nuk shihen kriteret se kur duhet të fillojë ai ndryshim, për çfarë arsye duhet të fillojë ai ndryshim dhe cilave lëmi duhet t'u jepet prioritet për ndryshim të planifikimit hapësinor nëse ka nevojë. Mirëpo nevoja për rishikim do të jetë e domosdoshme, sepse materiali në letër dhe realiteti janë shumë larg njëri-tjetrit. Mbetet për t'u dëshiruar se a do të mund të realizohet deri në vitin 2015. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës fjalën e ka Mazllom Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA - Edhe Grupi i AAK-ës në këtë Kuvend e ka shqyrtuar me një kujdes të veçantë Planin hapësinor të Kosovës duke klasifikuar si një dokument të rëndësishëm, me të cilin pretendohet të shënohen kornizat e zhvillimit hapësinor për një periudhë të caktuar kohore 10- vjeçare duke vlerësuar, mbrojtur, kultivuar dhe zhvilluar në një planifikim hapësinor të Kosovës. Në këtë drejtim dokumentin që kemi në dorë, e kemi punuar për një kohë të gjatë, sa di unë që nga viti 2003, me grupe dhe ekspertë kryesisht të brendshëm i debatuar gati në të gjitha komunat dhe me struktura të veçanta në bashkëveprim me sektorë të ndryshëm. Pra, ka arritur deri te ky formësim që duke mënjanuar iluzionet nuk është i përkryer dhe nuk pretendon të jetë i tillë, sepse është dhënë në kornizat e një periudhe të zhvillimit të Kosovës që duhet të jetë dinamike me ndryshime dhe sfidat me të cilat do të përballemi do të kërkojnë korrigjime, plotësime, përmirësime gati të përhershme.

Hapësira ka rëndësi kyçe për zhvillimin e një shoqërie e cila ndikon në përcaktimin e prioriteteve për investime për të cilat nuk mund të vendoset brenda natës. Prandaj, konsiderojmë se është koha e fundit që të kemi një dokument që merret me këtë problematikë dhe ky është Plani hapësinor e jo strategjia.

Përmbajtja e tij na ofron rrugën e zhvillimit të ardhshëm të Kosovës për 10 vjetët në vijim në bazë të rregulloreve në fuqi. Ky afat është fleksibil, shqyrtimi i dokumentit mund të bëhet varësisht nga kërkesat që paraqiten, gjithnjë duke mos e cenuar parimin kryesor, shfrytëzimin sa më racional të hapësirës.

Plani hapësinor i Kosovës është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës për një zhvillim më të shpejtë ekonomik me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojtjes së resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

Sa i përket gjendjes aktuale, e mira e Planit hapësinor është se nisët nga realiteti, nga zhvillimet që po ndodhin në Kosovë, që janë kryesisht të paplanifikuara edhe pse në disa sektorë janë bërë përpjekje për hartimin e strategjive të ndryshme. Mirëpo, nuk mund të kapërcejmë realitetin se disa treva që tradicionalisht, për arsye të njohura dhe të panjohura, janë të përballur me probleme sociale të papunësisë dhe të varfërisë ende po vazhdojmë të përballemi me to, në krahasim me trevat e tjera ku ka një zhvillim, por është i paqëndrueshëm dhe nuk i nuk plotëson kriteret themelore të një zhvillimi hapësinor.

Po ashtu, edhe mjedisi si resurs i pakompensueshëm është duke u atakuar nga të gjitha anët dhe format e mundshme, duhet shndërruar në të shumtën e rasteve në midis pa vlerë dhe pa të ardhme të qëndrueshme.

Synimet e planifikuara në këtë dokument pretendojnë të përcaktojnë shtegun për uljen e shkallës së lartë të papunësisë të udhëzojnë zhvillimin e planifikuar të vendbanimeve, të përmirësojnë infrastrukturën në vendbanime në zona rurale, kështu të përmirësohen mundësitë për një jetë më të mirë dhe të lehtësojnë qasjen në banim dhe shërbime për të gjithë.

Po ashtu, Plani i propozuar është bazuar në rend të parë në forcimin e qendrave të mëdha urbane si tha edhe ministri, shtirë nga mjete përkatës i infrastrukturës për rrjetin urban dhe forcimin e lidhjen në mes të qendrave të mëdha dhe atyre të vogla urbane, decentralizimi dhe format e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore më afër qytetarit. Inkurajimi në bujqësi dhe industrisë përpunuese e shërbyese si sektorë të fortë për të shtytur zhvillimin e balancuar ekonomik në kontestin urbanë rural, rehabilitimin e industrisë së rëndë në favor të zhvillimit më të fuqishëm ekonomike, rritjes së konkurrencës në tregun rajonal përmes shërbimeve efikase tregtare, rritjes së ofertës së turizmit, promovimit dhe forcimit të turizmit rekreativ e kulturor si sektor me rëndësi për zhvillim ekonomik të Kosovës.

Plani hapësinor rekomandon forcimin e rrjetit të brendshëm të infrastrukturës dhe integrimin e tij në rrjetin rajonal dhe evropian të transportit që karakterizon edhe me lidhjen e korridoreve të ndryshme. Pa dyshim ky dokument hap edhe dilema.

Së pari, Plani hapësinor përfshin edhe disa udhëzime politike të planifikimit për komunat të cilat kanë karakterin e përkrahjes së planifikimit komunal në lidhje me çështje të cilat në planin hapësinor kanë karakterin qendror të vendimmarrjes. Ato tentojnë të minimizojnë konfliktet në mes të planit hapësinor të Kosovës dhe planeve zhvillimore komunale.

E dyta. Meqë jemi në procedim për planin zhvillimor hapim edhe këto probleme aktuale. Cili është raporti i këtij dokumenti me dokumentin strategji dhe plani zhvillimor për Kosovën 2007 – 2013 që po hartohet nga Qeveria? A parasheh plane të veprimit dhe cila është kostoja e tyre? Besoj se këto çështje të ngritura duhet të merren parasysh nga Qeveria. Ndërsa ,në mbyllje janë edhe dy vërejtje.

Në bazë të Ligjit për planifikimin hapësinor, neni 7, Qeveria me sa duket ia ka kaluar këtë kompetencë Kuvendit, duhet të ngritet Këshilli për Planifikimin Hapësinor të Kosovës, këtë detyrim ligjor nuk e kemi bërë. Prandaj, sot do të ndihemi keq për vërejtjet tona për këtë dokument. Po sugjerimet, plotësimet, vërejtjet tona ku do t'i adresojmë? Prandaj, propozoj që me miratimin e këtij plani të merret vendim i afatizuar për ngritjen e Këshillit të Planifikimit Hapësinor të Kosovës.

Tjetër. Propozoj që motoja e këtij dokumenti në faqen e parë “Kosova është shtëpia jonë”, të korrigohet në, “Kosova shtëpia ime”. Jam i sigurt se edhe ata që kanë shënuar nuk e kanë të qartë domethënien e saj. E jona do të thotë e të gjithëve dhe e askujt. Kosova shtëpia ime, ka një domethënie tjetër, sepse është modifikuar me një thënie që ka një historiat 70- vjeçar dhe e di z. ministër me siguri, madje kjo ka hyrë edhe në shkollat

tona si temë e hartimeve shkollore, si temë e debateve e programeve mësimore në kuadër të edukimit mjedisor.

S'kemi pse e ndryshojmë, më së paku kemi arsye ta ndryshojmë.

Tjetër, dokumenti parashihet të monitorohet dhe të rishikohet pas 5 vjetëve. Propozoj se duhet ndryshuar duke shënuar, kohë pas kohe dhe jo më shumë se 2 vjet me propozimin e Këshillit për Planifikimin Hapësinor .

Z. kryetar si Grup Parlamentar e mbështesim këtë dokument me këto propozime dhe vërejtje tona. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. deputet. Në emër të Grupit Parlamentar ORA, fjalën e ka z. Gazmend Muhaxhiri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHIRI – Faleminderit z. kryesues. Planifikimi strategjik është një proces me të cilin një shoqëri e formëson të ardhmen e vet.

Me Ligjin mbi planifikim hapësinor dhe formimin e Institutit për Planifikim Hapësinor Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka futë Kosovën në rrjedhat e planifikimit Evropian dhe nga kjo foltore dua përgëzoj edhe ministrin edhe punëtorët e Institutit për Planifikim Hapësinorë, mirëpo edhe gjithë punëtorët e ministrive të tjera sidomos stafin e mesëm dhe stafin e ulët që punon në Qeveri që me bashkëpunimin e tyre të ngushtë dy vjet e gjysmë kanë punuar në hartimin e këtij plani.

Planifikimi nevojitet në ato vende ku ka më së paku gjasa të funksionojë. Planifikimi mund të funksionojë në ato vende që kanë komisione efektive të përcaktimit të politikave, mbështetës të fuqishëm të procesit, ekipe të mira të planifikimit ,qëndrueshmëri të mjaftueshme në sistemet e tyre për të përballuar çrregullimet dhe vonesat, përvojë në trajtimin e problemeve dhe një dëshirë për të përcaktuar çfarë është vërtet e rëndësishme për vendin.

A i ka përfillë të gjitha këto kritere Ministria ,por edhe Qeveria që e ka sjell këtë draft-Planit hapësinor në Kuvendin e Kosovë?. Se sa ka qenë serioze dhe sa e kanë mbështetur këtë proces Qeveria edhe Ministria e tregon fakti se që 3 vjet edhe pse me udhëzim administrativ të kryeministrit të parë të Kosovës z. Bajram Rexhepi ,është nxjerrë një Urdhër administrativ për formimin e Këshillit për Planifikim Hapësinor ,Qeveria as sot nuk e ka formua këtë Këshill. Do me thanë jemi ose punëtorët e Institutit për Planifikim Hapësinor kanë prodhuar një dokument në bashkëpunim me të gjitha ministrinë tjera i cili nuk e ka pasur një përkrahës të fuqishëm prapa tij, që qëndron pas këtij planifikimi dhe Kuvendi i Kosovës, mirëpo edhe Qeveria e cila e ka miratuar në seancë ose në mbledhjen e saj këtë draft, ka qenë e detyruar që në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor të ketë mendimin e Këshillit për Planifikim Hapësinor. Këshilli për Planifikim Hapësinor sipas nenit 7 pika 7.2 jep mendimet, propozimet dhe vërejtjet në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe në dokumentet e tjera të përcaktuar me këtë ligj të cilat i miraton Qeveria ose Kuvendi i Kosovës. Me çfarë akti ose me çfarë të drejte Qeveria e ka prurë këtë draft ligj në Kuvend të Kosovës, pasi ajo nuk e ka pas raportin e

Këshillit për të cilën është i obliguar me ligj ta trajtojë një herë në mbledhjen e saj e mandej t'ia sjellë Kuvendit të Kosovës për miratim. E kemi neni 11 të Ligjit për planifikimin hapësinor, i cili thotë decitivisht: Por sa të jetë finalizuar drafti Ministria ia dërgon Qeverisë atë për miratim paraprak dhe Qeveria ia procedon Kuvendit për aprovimin përfundimtar. Kuvendi i Kosovës nuk ka asnjë ekspert i cili mund të vlerësojë se a ka rrjedh ky proces në mënyrën e paraparë me ligj, nuk e ka as këshillin profesional i cili është dashur me i sugjerue Qeveris por edhe sot Kuvendit të Kosovës me një letër përcjellëse, me një shkresë se plani hapësinor i Kosovës duhet të miratohet. Thjeshtë jemi tash në dilemë çfarë duhet të bëjmë. Ligji nuk është respektuar. Kemi një plan, besoj të punuar mirë, por besimi ose njohuritë që i kam unë nuk mund ta bindin këtë Kuvend se duhet ta miratojë këtë plan. Unë nuk di se Qeveria në bazë të cilave këshilla dhe në bazë të të cilave rekomandime e ka miratuar këtë draftplan dhe e ka sjellë këtu para Kuvendit. As sot kur debatojmë këshillin profesional për hartimin e planit hapësinor të Kosovës nuk e kemi konsultuar. Duhet gjetur një mekanizëm dhe të formohet ky këshill dhe ai të japë rekomandimin e vet, së pari Qeverisë e pastaj Qeveria sipas Ligjit mbi planifikimin hapësinor ta procedojë draftin në Kuvend ,kurse Kuvendi i Kosovës me e miratua me një votim. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Muhaxhiri. Në emër të Grupit Parlamentar 6+ për fjalë është paraqitur Rifat Krasniq.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ – Faleminderit z. kryesues. 9.01.2007. tarihinde dizenlenen toplantıda Parlamentonun Tarımcılık ve Çevre Komisyonu, Kosova Alan Planı hakkında şu kararı aldı:

1. Kosova alan planı hakkında Meclis, Yasa Tasarılarıyla ilgili öngörülen işlemleri yerine getirmeye zorunlu değildir, fakat Fonksiyonal Komisyon, diğer Komisyonların değerlendirme sonucu olarak kendi değerlendirmesini yapmalıdır, çünkü sözkonusu plan ile toplumun çeşitli dalları çapraz haline gelmektedir.
2. Bu günkü Meclis toplantısında, bu planın tüm Meclis Komisyonları tarafından ilerideki safhada görüşülmesinin gerekli olup olmadığı kararlaştırılmalıdır.
3. Bu belgenin Mecliste onaylanmasıyla, ortaya atılan güçlükler azalmıyor, çünkü burada ortaya atılan uyarılar sayesinde sürekli olarak tamamlanan belgeden söz edilmektedir.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Për fjalë është paraqitur deputeti Xhevet Bislimi, paska dal jashtë. Fjalën e ka deputeti Luzlizm Zeneli .

DEPUTETI LULZIM ZENELI – Z. kryesues .i nderuar z. ministër. Pasi që edhe si pjesë e Komisionit Parlamentar për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e konsiderojmë si barrë e përgjegjësi që kjo çështje me rëndësi kaq të madhe dhe unë do të thoja me rëndësi kapitale për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit të adresohet në mënyrë çfarë është e njohur jo vetëm në parlamentet e rajonit, mirëpo edhe unë do të thoja edhe ato me traditë demokratike.

Një e para çka duhet të theksohet në këtë rast është se sot bëhet një punë e mirë që duhet të vlerësohet edhe puna që është bërë jo vetëm nga ana e Ministrisë dhe në veçanti nga Instituti për Planifikim Hapësinor. Dhe çështja tjetër që i takon këtij Parlamenti është se

sot po hapet një kapitull .unë do të thoja një kapitull i debatit dhe i diskutimeve që duhet të vazhdojë nëpër komisionet parlamentare dhe në mbështetje të qëndrimit që është shprehur nga ana e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-ës e konsideroj se kjo çështje duhet të procedohet në mënyrë që edhe komisionet parlamentare ta thonë fjalën e vet, ashtu siç kanë pasur rastin ta thonë jo vetëm në aspektin e nivelit ministror në të gjitha dikasteret ministrore, po ashtu edhe shoqëria civile përmes debatit , seminareve dhe takimeve të ndryshme që janë zhvilluar deri në këtë fazë.

Prandaj, jam i mendimit që sot kjo çështje të procedohet për diskutim nëpër komisione parlamentare dhe një prej seancave të ardhshme edhe ta marrë fjalën përfundimtare. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Zeneli. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryesues, z. kolegë deputetë dhe ministra.

Dokumenti për planifikimin hapësinor është njëri prej dokumenteve dhe projekteve më të rëndësishme për një vend. Prandaj, mendoj që Qeveria ka bërë mirë që ka marrë këtë hap. Duhet të falemendojmë edhe teknikën, kompjuterët e sotëm që na kanë mundësua të bëjmë plane e projekte me një lehtësi shumë më të madhe se përpara. Por puna është se koalicioni qeverisës aktual, por edhe qeverisja vendore që pas luftës e këndeje janë për mendimin tim përgjegjësit kryesor për këtë kaos, për këtë ndërtim të egër për shndërrimin e Kosovës në një xhungëll ,siç është bërë sot. Pak besim mund të kemi ne, pak besim mund të ketë qytetari se qeverisja që është përgjegjëse për këtë gjendje në Kosovë mund ta shërojë dhe ta ndalë këtë rrënim- degradim të mëtejshëm të hapësirës së Kosovës.

Pastaj bashkohem me të gjitha vërejtjet që i bënë deri tash kolegët e tjerë dhe është mirë ndoshta e para punë që duhet të bëjë të konstitujë atë këshill profesional hapësinor, pastaj të hapet debat edhe në këshillat komunale dhe një tjetër çështje që është me rëndësi, për të cilën duhet ta jap përgjigje ministri edhe Qeveria. Unë jam shumë i interesuar të di nëse ky projekt, ky plan do të gjejë zbatim në tërë territorin e Kosovës apo do të ketë fatin e ligjeve dhe të projekteve të tjera të cilat zbatohen diku, diku në Kosovë por diku, diku nuk zbatohen ose nuk gjejnë zbatim. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Për fjalë është paraqitur Behxhet Brajshori

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI - Z. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar deputetë. Pa dyshim se kemi një dokument shumë kapital para vetes. Si deputet i Kuvendit të Kosovës edhe unë përgëzoj Ministrinë që e ka sjell këtë dokument para nesh, por kërkoj një angazhim më të madh të deputetëve.

Dokumenti ka kaluar shumë faza të diskutimit publik dhe është hartuar në bashkëpunim me shumë institucione profesionale të shoqërisë civile dhe të segmenteve të tjera të shoqërisë në përgjithësi. Do të thotë është në duart e Parlamentit të Kosovës çka duhet bërë më tej me këtë dokument. Në të vërtetë, sa ky dokument siguron përgjigje pozitive në problemet që ministri i theksoi si probleme të identifikuara gjatë hartimit të Planit hapësinor të Kosovës.

Sa ky plan hapësinor i Kosovës në pajtim me Ligjin për planifikimin hapësinor ndalon aktivitete të ndryshme për të mosshfrytëzuar më tej tokën bujqësore, në mënyrë

poracionale resurset natyrore, hapësirat ku mund të gjendet trashëgimi e caktuar kulturore dhe shumë aspekte të tjera.

Prandaj, mendoj se ka vend për një angazhim të secilit prej komisioneve të Kuvendit të Kosovës, bile shumë seriozisht. Nëse kërkon që të miratohet e duhet të miratohet në Kuvendin e Kosovës një dokument i tillë, qasja duhet të jetë joprovizore, jo thjeshtë sa për ta kaluar, por shumë serioze për ta ndihmuar sponsorin dhe për të pasur një dokument i cili pastaj do të shërbejë si bazë se kah në të vërtetë shkon në gjitha aspektet e zhvillimit, jo vetëm ekonomik, planifikimin hapësinor që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të vendit. Prandaj, mendoj se një kohë na duhet të gjithë deputetëve dhe unë thërras deputetët që nëse jo në të gjitha ligjet kemi qenë gjithnjë prezentë në komisione, që nuk dyshoj se ka qenë pjesa më e madhe, vërtet me rastin e diskutimit të këtij dokumenti nëpër komisione parlamentare të kemi një qasje shumë të angazhuar. Ju faleminderit !

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Brajshori, për fjalë është paraqitur Xhezair Murati.

DEPUTETI, XHEZAIR MURATI - Hvala gospodine predsedavajući! Mislim da neće biti na odmet ako ovaj iznesem kao i moj prethodni kolege niz ovaj dobrih pohvala za trud koji je uloženi za profesionalno uradjen ovaj Nacrt Prostornog plana Kosova, zaista profesionalno odradjene mnogo detalje, ali ja abih se u jednom sesgmentu zadržao na izlaganje Ministra, kada je spomenuo da je Kosovo, pojedinci, površine najgušće naseljeni prostor u smislu objekata koji zahvataju površine Kosova i da mi te objekte na neki način trebamo, ako mogu da ga tačno parafraziram na neki način da legalizujemo. U tome nisam čuo razmišljanja šta ćemo sa objektima koji koče proširenje putne mreže sa objektima koji su eventualna opsanost o obezbednost gradjana, recimo blizina pumpi, do magistrale i tako dalje, gde nije profesionalno prema kriterijumima koje ima Evropska Unija i zakonodavstvo čemu težimo i sami da abudemo, na koji način, koji su mehanizmi koje ćemo kao Skupština upotrebiti da bi smo generacijama dakle stanovništvu omogućili veću bezbednost kako zaustaviti širenje prostora odnosno stanova i objekata na račun veoma kvalitetnog zemljišta sa nekim nepreciznostima kada su u pitanju brojke, recimo ne pominjaju se nigde od prilike o nekoj decentralizaciji kako i na koj način opštine gde će se svrstavati ka kojim centrima, potom mehanizme na koj način da legalizujemo ono što je od opšteg interesa i da ekspropirano i da ekspropiramo ili ovaj uklonimo ono što je od opšte opasnosti, dakle razvojit te dve stvari ili podatke kada baratamo recimo sa Prizrenom da ima sa okolinom 306 hiljada stanovnika, da u njemu žive, da u tom centru, odnosno u tom regijonu 65% stanovnika čine, ovaj čini stanovništvo na selu a sam Prizren ima 180 hiljada što na osnovu brojke odmah čini 50%. To su neke sitne nepreciznosti, kako zaustaviti i smanjiti eroziju. Nisam primetio i ako sam kratatk u vidima odakle, šta činiti sa procesom pošumljavanja i zatravnivanja golih površina kako bih smo na neki način uravnotežili padavine i smanjili eroziju, jer se pominje da smo manje erozivno područje od Aalbanije ali ne pominjemo koliko smo više erozivno poručje od nekih drugih sredina. Znači, treba pomenuti kao primer onaj koji je lošiji od nas ali treba pomenuti i primere koji su bolji od nas i da težimo ovaj ka takvoj jednom cilju, u tom smislu dakle, ja ovoga puta kao poslanik zaista izražavam zadovoljstvo što je mnogo truda uleženo, ali isto tako daljnje naše percepiranje odnosno pripreme kako bi smo uhvatili korak sa razvijenim svetom, da uklonimo sve ono što vidimo što je dobro kod drugih i tako dalje. Evo toliko za sada. Hvala!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Murati. Për fjalë është paraqitur deputeti Fetah Berisha

DEPUTETI FETAH BERISHA – Ju faleminderit Z. kryesues. Meqë edhe unë jam njëri nga ata që bëjnë pjesë në Komisionin për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor, desha të qartësoj se ky nuk është Projektligj, por ky është Projektplan i planifikimit hapësinor të hapësirës së Kosovës, dokumenti është shumë i rëndësishëm për Kosovën. Kosova është një hapësirë fare e paplanifikuar, kjo nuk është sëmundje e kësaj apo e asaj qeverie që dikush tenton ta paraqesë, por kjo është plagë shumë e moçme, “plagë”, pra është nevojë shumë më e moçme, por nuk ka mundur të bëhet. E përgëzojmë Ministrinë e Planifikimit Hapësinor e cila ka bërë punë shumë të madhe në përpilimin e këtij dokumenti, i cili në të ardhmen, natyrisht, gradualisht edhe do të jetësohet.

Çfarë pune ka bërë Ministria e Planifikimit Hapësinor, ka bërë këtë: disa herë me Komisionin për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor kemi takuar në mes veti, bile bile nja dy herë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor kemi shikuar edhe filmin e përpiluar nga ekspertët e kësaj Ministrie. Pastaj kjo Ministri në bashkëpunim edhe me ne ka bërë dhe kontakte me përfaqësuesit e ndryshëm të komunave të ndryshme, prandaj është bërë një punë e madhe. Ky projekt me këtë punë të madhe të nisur duhet gradualisht edhe të vihet në jetë. Ky projektplan e lenë mundësinë dhe në të ardhmen që gradualisht të jetësohet, prandaj në Komisionin tonë kemi marrë vesh, nuk kemi paraqitur gjë me shkrim, por kemi marrë vesh që ky dokument të aprovohet në parim këtu në këtë seancë e pastaj vazhdimisht dhe gradualisht të punohet edhe për jetësimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. deputetë. Për fjalë është paraqitur deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit z. kryesues. Unë me shumë vëmendje, si dhe Grupi parlamentar e kemi shqyrtuar këtë Projektplan duke pasur parasysh nevojën për hartimin e këtij Projektplani dhjetëvjeçar dhe situatën në të cilën ndodhemi.

Unë e përgëzoj ministrin për një paraqitje shumë të mirë, të detajuar duke marr parasysh jo vetëm të mirat e planit, por edhe defektet e planit dhe sfidat të cilat paraqiten në implementimin e këtij plani.

Kam përshtypjen se shumica e deputetëve nuk e kanë lexuar me kujdes dhe shpresoj që më vonë do ta lexojnë me një kujdes më të madh, me qenë se temë kryesore është kritika e Qeverisë, por jo edhe vetë përmbajtja e Projektplanit ose ndonjë sugjerim konkret i cili do të ndihmonte në kalimin e këtij plani dhe implementimin e tij. Siç e tha edhe vetë ministri, ky plan supozon se do të ketë natyrisht ndryshime gjatë implementimit të tij. Mendoj, në qoftë se plani kalon në Komision edhe Komisioni nuk ka me qenë në gjendje që në mënyrë të përkryer ta saktësoj më shumë planin dhe sidomos duke marrë parasysh se kërkesa e disa nga deputetëtve ishte me u shqyrtua edhe me të tjerët dhe me pasë debat, kurse ministri veç e shpjegoi që ka ekzistuar debati publik. Mendoj që duhet ta aprovomë në parim këtë dhe pastaj më vonë, në suazat e më vonshme, në qoftë se ka nevojë për ndryshimet, mundemi prapë së bashku me Qeverinë me i bë këto ndryshime. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI - Ju faleminderit! 2 minuta i ka kërkuar Selvije Halimi

DEPUTETJA, SESLVIJE HALIMI – Ju faleminderit z. kryesues, më falni kolegë deputetë, por vetëm desha të sqaroj si anëtare e Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

Në mbledhjen e fundit të Komisionit ka ardhur Projektplani hapësinor si pikë e rendit të ditës dhe kemi diskutuar, mirëpo as nuk kemi votuar dhe as nuk jemi marrë vesh me konsensus që t'i japim mbështetje si Komision. Ekemi lënë që të vendoset në Kuvend, qoftë si grupe parlamentare, qoftë si deputetë. Vetëm desha ta informoj opinionin se kështu ka shkuar rrjedha e Komisionit.

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Konstatoj që diskutimet kanë përfunduar. Tani fjalën e ka ministri Adrian Gjini

ADRIAN GJINI, MINISTËR- Ju faleminderit z. kryesues. Unë sinqerisht dua t'i falënderojë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës të cilët sot kanë diskutuar rreth Planit hapësinor. Është evidente se disa prej deputetëve kanë njohuri më tepër për planin se disa tjerë për shkak të punës së tyre profesionale, mirëpo edhe për shkak të kyçjeve së tyre gjatë procesit të hartimit të planit Z. Muhaxheri, z. Kumnova kanë punuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe janë shumë në ngjarje me ato që kanë ndodhur, mos me i përmendur edhe deputetët e tjerë.

Në çdo komunë të Kosovës ka pasur debat për planin hapësinor të Kosovës. Në shumicën dërmuese të komunave kam qenë edhe unë. Është punuar për më shumë se 3 vjet. Mendoj se një punë e tillë është tepër profesionale, në fund të fundit është Kuvendi sovran që vendos a do, se si do të procedoj në fund të fundit dhe nëse vendimi i Kuvendit është që të procedohet nëpër komisione parlamentare, atëherë do të procedohet në komisione parlamentare dhe është çdo gjë në rregull. Mirëpo mendoj se është shumë e drejtë të thuhet se jemi vonuar me krijimin e Këshillit për Planifikim Hapësinor. Këtë këshill duhet ta krijojë Kuvendi i Kosovës, kanë ndërruar disa vendime z. Muhaxheri dhe Kuvendi i Kosovës duhet ta themelojë Këshillin e jo Qeveria e Kosovës. Unë mendoj se ekziston edhe një rrugë e ajo rrugë është që të aprovohet plani dhe në të njëjtën kohë që shumë shpejtë të emërohet ky këshill dhe të fillojë të bëjë rekomandime. Me qenë se Plani hapësinor i Kosovës duhet të rishqyrtohet shpesh, nuk është një plan që aprovojmë sot dhe do të punojmë me to për dhjetë vite. Përkundrazi duhet të punojmë me të vazhdimisht dhe duhet të punojmë shumë shpesh. Edhe një çështje të fundit që kisha dashur ta ngrisë është që vetëm të bëhet dallimi mes planifikimit urban dhe rregullativ nëpër komuna dhe atij hapësinor të Kosovës. Plani hapësinor i Kosovës nuk tenton që t'u tregojë komunave se sa banorë do t'i kenë, as nuk tenton as nuk guxon që t'i kufizojë apo t'i ndalojë mirëpo i paraqet parametrat e zhvillimit. Nëse guxoj para jush të jem pak deskriptiv, plani hapësinor tenton të mos lejojë që në Gryken e Rugovës të ndërtohet një fabrikë për prodhimin e kemikateve, kjo është ajo çka synon Plani hapësinor i Kosovës.

Zhvillimi urban, rregullimi, urbanizmi, ato janë çështje të cilat ju takojnë komunave për shkak se Kosova ndërtohet në dy nivele të qeverisjes dhe kemi rregullore dhe ligje të cilat i përcaktojnë përgjegjësitë edhe të komunave përpos se të Kuvendit dhe në kuvendin e Qeverisë. Ju faleminderit edhe një herë. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Gazmend Muhaxheri me qenë se ju ka përmend emri – 2 minuta.

DEPUTETI, GAZMEND MUHAXHIRI - Ju faleminderit z. kryesues. Vetëm ta informojë Kuvendin, por edhe ministrin.

Ligji për planifikim hapësinor nuk është ndryshuar dhe nuk ka ardhur në Kuvend të Kosovës që të ndryshohet. Po i referohem Ligjit, neni 7 Këshilli për Planifikim hapësinor, me qëllim të sigurimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të Kosovës, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve të planifikimit hapësinor si dhe dokumenteve të tjera, Qeveria e Kosovës e formon Këshillin për Planifikim Hapësinor, kështu thotë ligji. Në bazë të këtij ligji kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi ka nxjerrë urdhëresën administrative, e cila nuk mund të ndryshojë, se nuk mundet Kuvendi me e formua Këshillin, por e formon Qeveria e Kosovës. Pra, derisa është ky ligj nuk mundet Kuvendi me formua këshill, e formon Qeveria. Nëse duhet me e formua Kuvendi, së pari duhet me u ndryshua ky ligj.

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. deputet! Tani diskutues nuk ka. Konstatoj që diskutimet e bëra deri më tani na kanë sjell në pikën kur ne duhet të votojmë lidhur me miratimin e këtij ligji – plani hapësinor - në lexim të parë , si po e quajmë dhe të njëjtin t'ia përcjellim komisioneve përkatëse, në qoftë se vërejtjet që u dhanë kanë vend për të bërë amendamente ose për të dhënë vërejtje lidhur me Planin hapësinor.

Atëherë lus regjinë që ta hap votimin për ta miratuar Projektin. Konstatoj që në Kuvend janë 73 deputetë, që do të thotë se ka kuorum të plotë. Pra ,regjia hapne votimin – Votojmë tani: Konstatoj që në sallë janë 76 deputetë

PËR kanë votuar 64 deputetë, KUNDËR kanë votuar 4 deputetë dhe kanë abstenuar 7 deputetë. Pra me 64 vota miratohet Projektplanin hapësinor i Kosovës dhe ngarkojmë të gjitha komisionet e Kuvendit të Kosovës që të përpiqen, të japin kontributin e tyre lidhur me zbatimin e këtij projekti dhe miratimin e mëtutjeshëm Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës

Shqyrtimi i Rekomandimit për emërimin e dy kandidatëve në Bordin e ankesave për media të propozuara nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe transmetimin, anëtarët vendorë të Bordit për ankesa të mediave caktohen nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas kërkesës publike të emërimeve nga Këshilli.

Rekomandimi për emërimin e anëtarëve të bordit bashkë me biografite e kandidatëve të propozuar që u janë shpërndarë të gjithë deputetëve dhe ata janë:

1. Avdi Dinaj – gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
2. Anton Nokaj – gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

Lidhur me propozimet e bëra, do të kërkoja një deklaram. Në qoftë se kanë kryetarët e grupeve parlamentare ose deputetë të thonë diç, mund të flasim, do të thotë ta hapin diskutimin. Ju informoj që votimi është i domosdoshëm dhe se Alush Gashi është paraqitur në emër të Grupit Parlamentar.

DEPUTETI, ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues, Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka marr Rekomandimin e Komisionit përkatës, të cilën e udhëheq zonja deputete Nekibe Kelmendi dhe ne i mbështesim kandidaturat e ofruara dhe do të votojmë për ta. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike z. Fehmi Mujota

DEPUTETI, FEHMI MUJOTA – Ju faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka konstatuar që janë përfillur të gjitha procedurat e përcaktuara me ligj nga Komisioni, nga Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Komisioni përkatës funksional ka bërë vetëm një punë rutine për të bartur propozimin, të cilin në fakt Gjykata Supreme merr vendim për të dhe Kuvendi rekomandon këta emra. Prandaj, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i mbështet këto kandidatura.

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Mujota. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës - deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA, GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar i Aleancës, duke u bazuar edhe në Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim si dhe të Komisionit gjithashtu i mbështet dy kandidatët e propozuar nga Gjykata Supreme. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar ORA - deputetja Teuta Sahatqija

DEPUTETJA, TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryesues! Nuk e di a ka pasur nevojë secili grup me u deklarua për këtë pasi këta emra janë emra të cilët propozohen prej Gjykatës edhe Kuvendi vetëm deklarohet me një votë formale, prandaj, nuk ka problem pasi u deklarua për ligjin që nuk janë ligje, plane në vend të ligjeve edhe për këtë nuk ka problem.

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI- Në emër të Grupit Parlamentar të Grupit për Integritet z. Sabit Rrahmani

DEPUTETI, SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. Kryesues. Grupi Parlamentar për Integritet e mbështet propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Ne i përkrahim kandidatët.

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Nuk ka të paraqitur të tjerë. E hedhim në votim propozimin. Në sallë janë 77 deputetë, kuorum ka për të votuar . Sipas ligjit shumica prezente e miraton. E hapim votimin. Votojmë tani:

Konstatohet që kanë votuar “Për” 65 deputetë, “Kundër” kanë votuar 6 deputetë dhe kanë abstenuar 5 deputetë.

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Rekomandimin për emërimin e anëtarëve vendorë të Bordit të Ankesave dhe Mediave. Ju faleminderit!

Tani kemi pikën e 12 të rendit të ditës

Njoftimi me interpretimin e dispozitës për emërimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor

Ne e kemi një interpretim që e ka bërë z. Ryker dhe kemi një interpretim të mëhershëm që për mbledhjen e Kryesisë e ka bërë z. B.Boluvje, përfaqësues ligjor i PSSP-së. Po e lexoj në tërësi shkresën që e ka qu PSSP-ja z. Ryker: “Votimi në seancën e kaluar të Ombudspersonit ishte i pasuksesshëm, d.m.th. se nuk është zgjedhur Ombudspersoni”. Ju i dini kundërthëniet në mes të Rregullores së UNMIK-ut dhe Rregullores së Kuvendit të Kosovës lidhur me Ombudspersonin Rregullorja jonë kërkon shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, ndërsa ajo e UNMIK-ut kërkon shumicën e votave të deputetëve, pra 61 vota.

Këto dispozita kundërthënëse kanë shkaktuar konfuzion në këtë çështje dhe për pasojë nuk kemi arritur të zgjedhim Ombudspersonin dhe zëvendësin e tij në kohën e planifikuar ngase asnjëri nuk ka fituar numrin e votave sipas Rregullores së UNMIK-ut. Në këtë situatë Kryesia ka sugjeruar që të shpallet konkurs i ri për për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit të tij.

Qëndrimi i Kryesisë është mbështetur në letrën e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut të dt. 16.12.2006. Letra konstaton se meqë asnjëri kandidat nuk ka marrë votat e nevojshme, atëherë votimi nuk konsiderohet i përfunduar, pra i suksesshëm. por, letra nuk rekomandon veprime të mëtejshme. Në ndërkohë, pas mbledhjes së Kryesisë ka arritur edhe një shkresë tjetër nga shefi i UNMIK-ut z. Ryker. Në këtë letër ai kërkon që të vazhdohet me votë me kandidatët e njëjtë deri në momentin kur njëri nga ata do të merrte votat e kërkuara ,pra 61 votë.

Lidhur me këtë koment sot kemi përcjell shqetësimin tonë te Zyra e PSSP-së, Nga ajo kemi marrë preferencën se interpretimi autentik do të bëhet në seancën e radhës dhe ai interpretim do të ketë karakter imperativ. Pra, ishte njoftim dhe mendoj që konform shkresës, ne duhet ta shtyjme diskutimin lidhur me këtë çështje për seancën e ardhshme, pasi që të komunikojmë edhe një herë me përfaqësuesit e UNMIK-ut kompetent për interpretimin e rregulloreve të tyre edhe të tonave bashkë.

Z. Hydajet e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

DEPUTETI, HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryesues. Në rend dite , siç u tha , e kemi njoftimin dhe unë dua ta falënderoj kryesuesin dhe Kryesinë për njoftimin e dhënë, veçanërisht edhe për referimin e teksteve të cilave edhe ne po i referohemi.

Megjithatë, njoftimi do të ishte i mangët edhe për deputetët edhe për opinionin nëse nuk do të respektohej si thuhet ajo maksima e latinëve të vjetër “Audiato retarte lapst “ –(le të dëgjohet edhe ana tjetër). Unë natyrisht që nuk mund të pretendoj që këtu tash të bëjë luftën e Don Kishotit edhe me Zyrën Ligjore të UNMIK-ut edhe me vetë Zyrën e Përfaqësuesit Special. Megjithatë e vërteta është vetëm një prandaj, unë mendoj se bëmë mirë që nuk vendosëm sot të mbështesim propozimin, për mendimin tim të gabuar , pa bazë juridike për të anuluar procesin e deritashëm të zgjedhjes, i cili nuk është kontestuar me asgjë dhe nuk mund të kontestohet dhe për të shpallur konkursin, sepse me këtë do të krijonin një precedent shumë të rrezikshëm dhe do të bënim shkelje të rëndë juridike edhe ne si Kuvend,por edhe ata që kanë sugjeruar, përfshirë Zyrën Ligjore të UNMIK-ut dhe Zyrën e Përfaqësuesit Special.

Më lenoni vetëm ta arsyetoj shkurtimisht. Rregullorja e UNMIK-ut procedurën e zgjedhjes ia ka deleguar Kuvendit të Kosovës. Komisioni është konsideruar autoriteti

kryesor dhe është kërkuar vetëm që votimi të jetë transparent dhe i rregullt. Është kërkuar shumica – mbështetja e shumicës së deputetëve, por çështja e rregullave të procedurës sipas të cilave do të zgjidhet Ombudspersoni (Avokati i Popullit) i është lënë Kuvendit. Ky Kuvend ka miratuar rregullat, në Rregullore nuk është paraparë votimi me shumë kandidatë. Kuvendi ka miratuar në pajtim me Zyrën Ligjore të UNMIK-ut me OSBE-në dhe me Institucionin e Ombudspersonin kandidaturat e shumë kandidatëve. Votimi me shumë kandidat është proces i përzgjedhjes së kandidatëve, prandaj është edhe proces i eliminimit të atyre që nuk fitojnë, por me shumë kandidatë kur nuk mund të sigurohet shumica absolute, është diçka elementare. Ne e kemi pasur edhe në procedurën e zgjedhjes së presidentit të Kosovës, prandaj Kuvendi ka miratuar rregullat sipas të cilave në rrethin e fundit konsiderohet i zgjedhur kandidati që fiton më shumë vota dhe kjo është mbështetje kushtimisht e kandidatit që fiton më shumë vota për gjithë procedurën. Megjithatë një shpërpushje është, prandaj zotëri unë propozoj që Kuvendi ta shqyrtojë seriozisht mundësinë që pas përfundimit të garës, të cilën nuk e ka kontestuar askush as kandidatët garues nuk e kanë kontestuar të votohet për një kandidatë siç kemi vepruar në rastet e ngjashme. Nëse kandidati fitues ka mbështetjen e shumicës së deputetëve konsiderohet pa asnjë mundësi kontestimi si i zgjedhur. Nëse eventualisht ai nuk e ka mbështetjen e shumicës së deputetëve, atëherë mund të shkohet në variante të tjera. Ky është propozimi im dhe unë ju lutem për ta shqyrtuar vërtetë me gjakftohtësi. Jam i bindur se kjo është në përputhje edhe me frymën e rekomandimeve edhe të Zyrës ILgjore të UNMIK-ut edhe Përfaqësuesit Special. Nuk kanë kërkuar ata anulimin e procesit të deritashëm, sepse nuk janë aq të papërgjegjshëm sa të kërkojnë një shkelje të rëndë të procedurave, të ligjeve nga ky Kuvend dhe nga vetë ata, prandaj të mos e lejojmë edhe ne ju lutem. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën

DEPUTETI, SABRI HAMITI - Z. kryesues. Unë besoj që ne shumë nuk duhet të bisedojmë sot për këtë problem, meqë ju e pat vetë. Të gjithë ata që pretendojnë që i interpretojnë më së miri rregulloret i kanë dhënë mendimet e tyre, bile edhe me shkrim dhe nuk kanë arritur në një përfundim që në letrën që lexoi Kryesuesi tha: Nuk e kemi vendimin imperativ që i bjen vendimin urdhërdhënës shqip vendimtar. Ju e dini shumë mirë që vendimi urdhërdhënës vendimtar deri më sot, na po harrojmë shpeshherë se fuqinë ekzekutive legjislativë e ka një njeri që i thonë Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm në emër të gjatë, prandaj meqë edhe ashtu sot nuk do të vendoset, mendoj që sot nuk do të duhej të bisedojmë më gjatë, por ta shtyjmë për mbledhjen tjetër . Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI – Mendoj që diskutimet rreth kësaj janë të tepruara, nuk ka nevojë mu diskutua më, mendimi është dhënë, propozimet janë dhënë. Mendoj se nuk ka nevojë Xhevat me diskutua, po nuk ka nevojë ,sepse ky ishte vetëm njoftim dhe nuk është hapur debat lidhur me këtë çështje. Urdhëro Xhevat!

DEPUTETI, XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit shumë! Unë desha të them se edhe kjo çështje që kemi sot në rend dite, provon edhe një herë si shumë herë deri me tash që e tha dikush këtu se ne po harrojmë nganjëherë kush jemi. Provon edhe një herë rolin, rëndësinë dhe peshën e institucioneve që i thonë të Kosovës. Unë mendoj se praktikat e dualizmit të rregulloreve duhet të marrin fund, sepse faji nuk është vetëm i

Përfaqësuesit Special, siç dimë të arsyetohemi dhe i asaj Zyrës së tij, por faji është edhe yni që kemi pranuar që 7 vite për 8 të jemi servis i zakonshëm i asaj zyre. Unë ftoj publikisht kryeadministratorin dhe Zyrën e tij që të vinë ta udhëheqin Kuvendin dhe të na thonë me kohë se çfarë mund të bëjmë, çfarë nuk mund të bëjmë dhe mos na marrin kohë kot. Andaj, Kolë Berisha, kryetari dhe Kryesia le të japin dorëheqje, le të vijë Rykeri t'i udhëheqë Kuvendin edhe Qeverinë dhe të gjitha institucionet dhe ta dimë kush është më, praktika e komunikimit me letra vërtetë po na merr shumë kohë, le të vijë ta marrë rolin aty që e paska edhe le të kryhet puna, mos të bëjmë cirkus.

KRYESUESI I SEANCËS XHAVIT HALITI- Faleminderit z. Bislimi. Uroj që vërtet ky vit në të cilin kemi hyrë nuk do të na gjejë më me dy parë rregullore, me dy parë statute. Megjithatë mendoj se përgjegjësinë më të madhe e kemi ne se PSSP-ja, sepse ai e kryen detyrën e vet që ia kanë ngarkuar. Kemi fushë dhe hapësirë mjaft për mi kryer detyrat tona, pra po procedojmë me pikën e 13 të rendit të ditës.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës është:

Kërkesa për emërimin e anëtarit të Kryesisë nga radha e komuniteteve joshqiptare dhe joserbe.

Siç e dini në mbledhjen e kaluar dhe në mbledhjen e Kryesisë ka pasur dyshime se a mund të jetë anëtar i Kryesisë anëtar i Grupit Parlamentar të AAK-së që në numër mund të bëhen dy anëtarë të AAK-së në Kryesi, që sipas Rregullores dhe Kornizës Kushtetuese nuk lejohet, Megjithatë tani prapë po dalim tek interpretimi i Përfaqësuesit Special të sekretarit të përgjithshëm z. Ryker, i cili e arsyeton dhe i jep mundësi kandidimit në fjalë. Po ua lexoj shkresën të cilën e ka dërguar: Me kërkesë të Kuvendit të Kosovës, Përfaqësuesi Special i përgjithshëm z. Ryker në shkresën adresuar Kuvendit ka theksuar se në pajtim me kreun 9, pika 1 pika 7 (dh) i takon komunitetit që të përcaktojë përfaqësuesin në Kryesi dhe se përfaqësimi politik në Grupin parlamentar i personit të përzgjedhur me marrëveshje është i parëndësishëm, shkresa e SPSP-së i është shpërndarë të gjithë deputetëve, prandaj konform rregullave i lus deputetët që me votim formal ta miratojnë propozimin që Bislim Hoti të jetë anëtar i ri i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

Në sallë janë 80 deputetë, numër i mjaftueshëm për të votuar. Ju lus që me votim formal të deklaroheni për propozimin.

Pra konstatoj se është miratuar vendimi. Njëkohësisht dëshiroj që z. Mahir Yagcilar, anëtar të Kryesisë së deritashme t'i falënderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e përgjithshëm që e ka dhënë gjatë mandatit të tij si anëtar i Kryesisë dhe z. Bislim i uroj sukses dhe uroj që të ndihet mirë në mbledhjet dhe punët e Kryesisë gjatë mandatit të tij.

Ju faleminderit! Konstatoj që seanca e sotme e planifikuar edhe për nesër mori fund.

Mirë u pafshim pra në seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.